



Tezë Masteri

POLITIKAT E KREDITIMIT TË BANKËS EKONOMIKE NDAJ SUBJEKTEVE EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PERIUDHA (2010-2016)

Kandidati:

Florent Dragidella

Mentor:

Prof.Dr.Rufi Osmani

Tetovë, 2018

DEKLARATË

Unë, Florent Dragidella student në studimet postdiplomike në Fakultet të Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore –Tetovë, deklaroj se ky punim masteri është punë hulumtuese e imja dhe se nuk është publikuar më parë nga autorë të tjerë. Çdo material që kam përdorur është deklaruar në tekst me referencë përkatëse dhe bibliografia përmban të gjithë literaturën që kam përdorur gjatë gjithë punës sime hulumtuese.

Jam i vetëdijshëm se çdo shkelje e rregullave të caktuara do të rezultojë me anulimin e këtij studimi empirik.

Nënshkrimi

Përmbajtja

Mirënjohje.....	5
Abstrakti.....	6
Абстракт	7
Abstract.....	8
1. Hyrje.....	9
1.1. Përshkrimi i studimit	9
1.2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit.....	9
1.3. Hipotezat e punimit të magjistraturës.....	10
1.4. Të dhënat e përdorura në punim.....	10
1.5. Metodologjia e hulumtimit.....	10
1.6. Organizimi i punimit.....	11
2. Rishikimi i literaturës	12
3. Sektori bankar në Republikën e Kosovës	14
3.1. Sistemi bankar në Kosovë – Aspekte historike	14
3.1.1. Struktura e menaxhimit ne sistemin bankar.....	16
3.2. Roli i sistemit bankar në përkrahjen e NVM-ve	20
3.3. Politikat bankare dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës	22
4. Potenciali kreditues i sektorit bankar në Republikën e Kosovës (2007-2016).....	24
4.1. Struktura e aktiveve dhe burimeve te aktiveve të industrisë bankare ne Kosovë	24
4.2. Shërbimet dhe produktet që ofrohen nga Bankat aktuale në Kosovë	27
4.3. Politikat e përgjithshme kreditore dhe shperndarja e portfolios kreditore	31
4.4. Krahasimi i normave të interesit në Depozita / Kredi.....	33
5. Performanca financiare e Bankës Ekonomike (2010 – 2015)	36
5.1. Analiza e bilancit të gjendjes.....	36
5.2. Analiza e bilancit të suksesit	41
5.3. Analiza e Cash-Flow	45
6. Procesi i kreditimit të NVM-ve në Republikën e Kosovës.....	52
6.1. Kreditë sipas aktivitetit ekonomik	52
6.2. Kreditë e reja.....	53
6.3. Afatet e kredive.....	54
6.4. Analiza e aplikacioneve kreditore për NVM-t në Banken Ekonomike	55
6.5. Përgatitja e analizës financiare , analizës biznesore dhe vlerësimin e riskut	56
6.6. Dokumentet e nevojshme për kredi biznesi	57

7.	Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës.....	59
7.1.	Ecuria e Kredive.....	60
7.2.	Ecuria e Depozitave.....	60
7.3.	Mikro bizneset	61
7.4.	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	61
7.5.	Klientët individual	62
8.	Trajtim empirik mbi NVM-të e marra si analizë rasti.....	64
8.1.	Analiza e rasteve të studimit.....	64
8.1.1.	Rasti i aprovimit të kredisë	64
8.1.2.	Rasti i refuzimit të kredisë	65
9.	Përfundimi dhe rekomandimet.....	67
10.	Literatura.....	69

Mirënjohje

Nëpërmjet këtij punimi mu dha mundësia të shqyrtoja një prej problematikave më aktuale në vend që i përket sferës ekonomiko-financiare. Pavarësisht se paraqet një problematikë komplekse, gjithësesi vullneti dhe puna gjithmonë japin rezultate të kënaqshme.

Falënderime dhe mirënjohje të shumta për të gjithë ata që më ndihmuan dhe mbështeten në rrugën e gjatë të përgatitjes së këtij punimi.

Pikë së pari e falënderoj Prof.dr.Rufi Osmanin për propozimin e kësaj tezë të magistraturës dhe për udhëzimet dhe mbështetjen gjatë përgatitjes të saj. Ka qenë ideatori i temës dhe konsulent i vazhdueshëm akademik dhe shkencor i saj. Falënderime të shumta për të gjithë profesorët e Fakultetit veçanërisht falënderime për Prof. Dr. Izet Zeqiri dhe Doc.Dr. Fitim Deari, të cilët kanë qenë gjithnjë promotorët dhe ndihmuesit për studentët e Masterit.

Sugjerime të pafundme literature, botime apo konsulta në çdo fazë të punimit. Krahas falënderimeve gjej rastin të shpreh vlerësime për profesionalizmin dhe vlerat e larta akademike që posedojn anetaret e komisionit per cka u jam mirenjohes pergjithëmon

Falenderimi i takon gjithashtu profesorëve të fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë pranë UEJL-it, kolegëve, shoqërisë dhe të gjithë personave të tjerë që më kanë mbështetur gjatë kësaj periudhe të studimeve postiplomike.

Mirënjohje pa fund për të gjithë familjen time, veçanërisht për prindërit e mi dhe vëllaun. Kanë qenë gjithnjë një motiv dhe mbështetje e madhe për shkollimin tim. Falënderime të veçanta për bashkëshorten time, që është gjithnjë në mbështetjen time dhe ka kontribuar me kritikën konstruktive dhe kohën e sakrifikuar familjare në funksion të këtij punimi.

Dua të shpreh mirënjohje edhe për gjithë ata që kontribuan në fillimin dhe realizimin me sukses të këtij rrugëtimi.

JU FALEMINDERIT TË GJITHËVE !

Abstrakti

Ky punim magjistrature në qendër të vemendjes ka analizën e performancës ekonomike dhe financiare të Bankës Ekonomike dhe krahasimin e saj me bankat e tjera të cilat operojnë në Republikën e Kosovës.

Nëpërmjet teknikave dhe metodave të Analizës së pasqyrave financiare, metodave të përgjithshme statistikore dhe metodave të thjeshta matematikore synohet të vlerësohet aktiviteti ekonomik i këtyre kompanive për periudhën 2010-2015. Analiza kryesisht do të bazohet në bilancet e gjendjes, të suksesit dhe bilancet e Cash Flow të Bankës Ekonomike dhe bilancit të gjendjes së dy kompanive të marra për analizë të shqyrtimit të aplikacioneve për kredi biznesi për të pëllogaritur indikatorët kryesorë që kanë të bëjnë me aktivitetin e kompanive në fjalë.

Një tjetër qëllim mjaft i rëndësishëm i studimit në këtë tezë të magjistraturës është për të parë edhe mënyrën që Banka Ekonomike në Kosovë i aplikon për targetimin e klientëve të NVM-ve , metodat që ajo i përdorë , procesin e aplikimit për kredi biznese duke filluar prej kërkesës së klientit për kredi gjetjes së klientit potencial për kredi, kompletimit të dokumentacionit , përgatitjen e analizave financiare dhe analizave biznese deri në procedimin e aplikacionit për aprovim dhe lëshimin e mjeteve të kërkuara në llogarinë e biznesit përkatësisht refuzimin e aplikacionit.

Me zhvillimin gjithnjë e më tepër të sistemit bankar, cilësia e kreditimit dhe faktorë të tjerë specifike kanë qenë gjithmonë një shqetësim jo vetëm për bankierët por për të gjithë ata që bëjnë pjesë në botën e biznesit, pasi mospërbushja e detyrimeve të njëjës palë mund të shkaktojë probleme serioze në situatën financiare dhe në treguesit ekonomik të palës tjetër.

Spektori bankar kosovar është karakterizuar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim nga zhvillime të rëndësishme që kanë ndikim të rëndësishëm në ekonominë e gjithë vendit.

Për aq kohë sa dhënia e kredive është një nga burimet kryesore të të ardhurave nga bankat tregtare, vetë menaxhimi dhe mbajtja nën kontroll e një cilësie të lartë të portofolit që lidhet me kreditimin ndikon natyrshëm në përfitueshmërinë e bankave.

Nëpërmjet metodave dhe teknikave të analizës financiare nga përlllogaritja e të dhënave financiare fitohen informacione relevante sa i përket vendimarrjes nga ana e bankave për aprovimin apo refuzimin e kërkesave të ndryshme për kredi biznese.

Ky studim do t'i shërbejë menaxherëve të lartë të bankave për të marrë masat e duhura në mbajtjen nën kontroll të këtyre elementeve të riskut që rezultojnë më të lidhur me përfitueshmërinë, dhe studiuesve e hulumtuesve të ardhshëm.

Абстракт

Овој магистрален весник се фокусира на економските и финансиските перформанси на Економската банка и нејзината споредба со други банки кои работат во Република Косово.

Со методите и методите за анализа на финансиските извештаи, општите статистички методи и едноставните математички методи имаат за цел да ја проценат економската активност на овие компании за периодот 2010-2015 година. Анализата главно ќе се базира на билансот на состојба на билансот на пари и паричен тек и на билансот на состојба на двете компании добиени за анализа на анализата на апликациите за бизнис кредити за да се опишат клучните индикатори за активноста компаниите во прашање.

Друга многу важна цел на студијата во оваа магистерска теза е да се разгледа начинот на кој економското банкарство во Косово аплицира за таргетирање на МСП, методите што ги користи, процесот на аплицирање за деловен заем кој се движи од барање за заем на купувачи \ потенцијален купувач на кредит, изработка на документација, подготовка на финансиска анализа и деловна анализа до обработката на барањето за одобрување и издавање на потребните средства во деловната сметка односно отфрлање на пријавата.

Со растечкиот банкарски систем, квалитетот на кредитирањето и другите специфични фактори секогаш биле загрижени не само за банкарите, туку и за сите оние кои се дел од светот на бизнисот, бидејќи неуспехот да се исполнат обврските на една страна може да предизвика сериозни проблеми во финансиската состојба и економските показатели на другата страна.

Косовскиот банкарски сектор се карактеризираше во текот на периодот што се разгледуваше со важни случувања кои имаат значително влијание врз економијата низ целата земја.

Додека обезбедувањето кредит е еден од главните извори на приходи од комерцијалните банки, управувањето и контролата на висок квалитет на портфолиото поврзани со кредитирањето природно влијае на профитабилноста на банките.

Преку методите и техниките на финансиска анализа од пресметката на финансиските податоци, се добиваат релевантни информации во врска со донесувањето одлуки на банките за одобрување или отфрлање на различни барања за бизнис кредити.

Оваа студија ќе им помогне на врвните менаџери на банките да преземат соодветни мерки за да ги задржат овие ризични елементи повеќе поврзани со профитабилноста и потенцијалните истражувачи и истражувачи.

Abstract

This master's thesis main goal is the financial and economic performance analysis of the Economic Bank and its comparison with other banks operating in the Republic of Kosovo.

Through the financial statement analysis techniques and methods, general statistical methods and simple mathematical methods are intended to assess the economic activity of these companies for the period 2010-2015. The analysis will mainly be based on the Balance Sheet of Cash and Cash Flow Balance Sheet and the Balance Sheet of the two companies received for analysis of business loan applications analysis to describe key indicators concerning activity the companies in question.

Another very important purpose of the study in this master thesis is to look at the way that Economic Banking in Kosovo applies for SME targeting, the methods it uses, the process of applying for a business loan ranging from customer's loan request \ potential customer credit finding, completion of documentation, preparation of financial analysis and business analysis up to the processing of the application for approval and issuance of required funds in the business account respectively rejecting the application.

With the increasingly developing banking system, lending quality and other specific factors have always been a concern not only for bankers but for all those who are part of the business world because failure to meet the obligations of one party can cause serious problems in the financial situation and economic indicators of the other party.

The Kosovo banking sector has been characterized during the period under review by important developments that have a significant impact on the economy throughout the country.

As long as the provision of credit is one of the main sources of income from commercial banks, the management and control of a high portfolio quality associated with lending naturally affects the profitability of banks.

Through methods and techniques of financial analysis from the calculation of financial data, relevant information is obtained regarding banks' decision-making on the approval or rejection of different business loan applications.

This study will serve top bank managers to take appropriate measures to keep these risk elements more associated with profitability and prospective researchers and researchers.

1. Hyrje

1.1. Përshkrimi i studimit

Bankat janë ndër institucionet më të rëndësishme për zhvillimin e një vendi në aspektin: ekonomik, arsimor, shkencor, kulturor, etj. Andaj me të drejtë bota bashkëkohore e konsideron si industri të veçantë dhe me ndikim të jashtëzakonshëm, pothuaj në të gjitha fushat e jetës dhe jo vetëm, për pranimin e depozitave në njërin anë dhe kreditimin në anën tjetër.

Aktualisht në Kosovë veprojnë 10 Banka të cilat ofrojnë shërbime dhe produkte të ngjajshme me njëra me tjetrën. Sot, me bindje të plotë mund të themi se radhitemi në shtetet të cilat në shumë aspekte cilësohen me rezultate të mira, sa i përket ofrimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve në regjion. Me fjalë të tjera, zhvillimet e hovshme të trendëve tekniko-teknologjike, kanë bërë që bankat komerciale të ecin tutje duke ofruar tërheqje dhe deponim në bankomate (ATM), pagesa me kartelë në P.O.S. terminale, transferet e parave me e-banking etj. Së fundi është duke u aplikuar edhe mënyra e informimit për kredi-marrje me anë të internetit si dhe përgatitja e aplikacioneve për kredi, duke kursyer kështu kohën dhe ardhjet fizike në bankë, për të marrë informacionin e dëshiruar.

Prandaj si një produkt i llojit të vet, në këtë punim diplome trajtohet procesi i kreditimit nga bankat e Kosovës me rast specifik Banken Ekonomike, pjesëmarrja e sektorëve në portfolion e përgjithshme kreditore, cilët janë sektorët që duhet të ngrisin shkallën e kreditimit e më këtë edhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik, në shtimin e vendeve të reja të punës, informaliteti i kredi-kërkuesve, risku i kredive, kreditë e këqijajo-performuese, relacionet BQK-bankat komerciale, lehtësitë në kreditim preferencial, sektorët që duhet të jenë me prioritet për kreditim preferencial, etj.

Ky punim është fokusuar gjithashtu edhe tek kategorizimi i subjekteve afariste ku do të veqohen në përgjithësi dy lloje të kategorizimeve në praktiken e funksionimit të afarizmit kosovar dhe atë sipas dhënies së kredive nga sistemi bankar, dhe sipas regjistrimit të tyre pranë agjensionit të regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARBK).

Në fund të punimit do të japë përfundimet dhe rekomandimet konkrete për Bankën Ekonomike në veqanti dhe për sektorin bankar në përgjithësi.

1.2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Qëllimi kryesorë i studimit në këtë tezë të magjistraturës është për të parë mënyrën që Banka Ekonomike në Kosovë i aplikon për targetimin e klientëve të NVM-ve, metodat që ajo i përdorë, procesin e aplikimit për kredi biznesore duke filluar prej kërkesës së klientit për kredi gjetjës së klientit potencial për kredi, kompletimit të dokumentacionit, përgatitjen e analizave financiare dhe analizave biznesore, vlerësimin e kolateralit të luejtshëm dhe të pa luejtshëm deri në procesimin e aplikacionit për aprovim dhe lëshimin e mjeteve të kërkuara në llogarinë e biznesit.

Ndërsa pas këtij procesi është edhe procesi i monitorimit të biznesit me vizita të rregullta. Në këtë temë mendojë ta bëjë edhe një sqarim të detajizuar për produktet që Banka Ekonomike në Kosovë i ofron klientëve të NVM-ve .

1.3. Hipotezat e punimit të magjistraturës

Hipotezat tona shkencore dhe hulumtimet e mëparshme të realizuara në këtë fushë së bashku me pyetjen tonë kërkimore formon bazën e këtij punimi. Që nga fillimi i zbatimit të kornizës rregullative të Bazeli-it, e në veçanti nga viti 2007, janë realizuar shumë punime shkencore për të vlerësuar nëse përmirësimet mbi kërkesat e kapitalit, menaxhimit të riskut dhe menaxhimit të likuiditetit kanë pasur ndonjë efekt tek bankat dhe se cilat ishin diferencat ndërmjet kërkesave të mëparshme.

Edhe, pse Komiteti i Bazeli-it për Mbikëqyrje Bankare ka filluar implementimin e Bazeli III, një numër i konsiderueshëm i vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim janë ende duke e bërë implementimin e Bazeli II, dhe në mënyrë graduale kanë filluar implementimin e Bazeli III.

Në funksion të lidhjes së lëndës dhe qëllimeve të hulumtimit në kuadër të këtij studimi, në këtë pjesë prezantohen dy hipotezat bazë:

1. Banka ekonomike ka zbatuar lehtësime shtesë në politikat kreditore për financimin e NVM-ve ne raport me bankat konkuresuese ne tregun bankar te Kosoves ,
2. Duke pas parasysh rritjen e konkurrenca në tregun bankarë të Kosovës, banka Ekonomike duhet të avansoj ne uljen e normave të interesit ne raport me bankat tjera.

1.4. Të dhënat e përdorura në punim

Ky punim magjistrature nuk dë të ishte në nivelin e tij të duhur pa burimin e informatave të duhura, prandaj është bërë një punë e madhe për të arritur qëllimet tona.

Për të arritur qëllimet tona, përveq literaturës profesionale, janë shfrytëzuar edhe të dhënat statistikore nga Banka Qendrore e Kosovës, Enti i Statistikave të Kosovës, Banka Ekonomike, mandej intervista të ndryshme me përgjegjësit e këtyre institucioneve etj.

Ky punim është arritur duke bërë një kombinim të të dhënave të ndryshme dhe duke i shëndrruar të dhënat e marrura në analiza financiare.

1.5. Metodologjia e hulumtimit

Koncepti teorik i këtij studimi është trajtuar në bazë të disa kërkimeve në fushën e industrisë financiare që trajtojnë dhe analizojnë veçanërisht çështjet e industrisë bankare, mënyrat e ndryshme të kësaj industrie, rregullativa e aplikueshme mbi rregullimin e kësaj lëmie, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe llojet e risqeve me të cilat përballet industria financiare.

Hulumtimi do të bëhet duke i aplikuar të gjitha standardet shkencore të cilat janë të matshme dhe cilësore të ciat kan për qëllim nxjerrjen e një përfundimi real dhe të krahasueshëm.¹

Zgjedha sistemin bankarë për të bërë këtë hulumtim pasi që dihet rëndësia e këtij sistemi në mbarëvajtjen ekonomike të Kosovës sepse vitet e fundit ndërgjegjësimi i popullatës dhe bizneseve për përdorimin e këtij sistemi është rritur ndjeshëm duke i kthyer bankat në institucione të patjetërsueshme për të kryer transaksione financiare ose për ti mbajtur kursimet e tyre si person fizik apo juridik.

Analizat e mia do ti bazojë në të dhënat e publikuara nga raportet vjetore të bankës në fjalë, Bankës Qëndrore të Kosovës dhe nga rastet faktike të cilat kanë ndodhur në bankë.

Periudha e marrë për analizë do të jetë 2010-2015, duke dashur që analiza të jetë sa më serioze, të paraqesë një bazë të besueshme informacioni dhe pasi që në këtë periudhë janë përfshirë një sërë ndryshimesh në vend të cilat kanë ndikuar veprimtarinë e bankës dhe si pasojë e faktit se kjo periudhë përfshinë vitet e para dhe pas paraqitjes së krizës financiare botërore .

1.6. Organizimi i punimit

Organizimi i këtij punimi, i kësaj teze të magistraturës me temë: "Politikat e kreditimit të „bankes ekonomike,, ndaj subjekteve ekonomike në republikën e Kosovës, periudha (2010-2016)" është bërë si vijon:

Ekzistojnë këto hipoteza kryesore:

1. Banka ekonomike ka zbatuar lehtësime shtesë në politikat kreditore për financimin e NVM-ve ne raport me bankat konkuresuese ne tregun bankar te Kosoves ,
2. Duke pas parasysh rritjen e konkurrenca në tregun bankarë të Kosovës, banka Ekonomike duhet të avansoj ne uljen e normave të interesit ne raport me bankat tjera.

Ky punim është organizuar në pesë kapituj: **Kapitulli i parë:**Hyrje; **Kapitulli i dytë:** Sektori bankar në Republikën e Kosovës; **Kapitulli i tretë:** Potenciali kreditues i sektorit bankar në R.Kosovës (2007-2016); **Kapitulli i katërt:** Performanca financiare e Bankës Ekonomike (2010 – 2015); **Kapitulli i pestë:** Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës dhe **Kapitulli i gjashtë:** Trajtim empirik mbi NVM-të e marra si analizë rasti. Thelbi i punimit është që pas analizave të kryera ti pranojmë ose ti hedhim hipotezat në bazë të rezultateve të fituara dhe të vijmë në konkluzionet dhe rekomandimet. Analiza përfshin gjendjen bankës Ekonomike në Kosovë gjatë periudhës 2010-2016.

¹ B. Mehmeti, (2008), metodat e hulumtimeve kërkimore-shkencore, Prishtinë.

2. Rishikimi i literaturës

Autorë të ndryshëm kanë argumentuar se rregullativa për ndërmjetsit financiar kanë një rëndësi të madhe të cilët rrisin cilësinë e investimeve në ekonomi, që në varësi edhe cilësia e kredidhënies të mbështetin një rritje ekonomike më të lartë dhe më cilësore e cila është e domosdoshme për të mbështetur punësimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Industria bankare karakterizohet nga problemi i riskut moral, i cili inkurajon bankat për të marrë përsipër më tepër risk.²

Ekspozimi ndaj riskut të tepër mund çojë në ngritje të kostos sociale. Trendi i globalizimit është duke e modifikuar strukturën e tregjeve bankare në mbarë botën, duke e nxjerrë në dukje çështje mjaft serioze që kanë të bëjnë me stabilitetin financiar.³ Kriza aktuale vërtetohet se shpejtësia e përhapjes dhe përmasat e pasojave negative të saj u përcaktuan edhe nga shkalla e ndërthurjes së sistemit financiar të vendeve të ndryshme midis tyre.

Kjo përcaktoj riskun e ekspozimit si edhe shkallën e eksportimit apo importimit të krizës. Kjo qartësohet me faktin se kriza globale u shfaq me valë goditëse të shkallëzuara në kohë. Vala e parë goditëse përfshiu vendet me sisteme financiare dhe ndërthurje në një shkallë shumë të lartë, ndërsa vala e fundit preku vendet ku shkalla e hapjes dhe ndërthurjes së vendeve të tyre ishte relativisht e vogël.

Në këtë grup përfshihen disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti Kosova. Risqet potenciale që bëhen akoma më të mprehta për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke qenë se sistemet bankare që ato kanë krijuar janë relativisht të reja dhe pa shumë eksperiencë.

Industria bankare e Kosovës, si shumë vendet e rajonit ka pësuar ndryshime të mëdha strukturore të rëndësishme gjatë periudhës së pasluftës. Hyrja e bankave të huaja solli një zhvillim dhe ristrukturim të tregut bankar, duke aplikuar praktikat ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve dhe shumëllojshmëri të produkteve në kuadër të industrisë bankare. Hyrja e bankave të huaja në tregun financiar, ndikuan në përmirësimin e mjedisit konkurrues.

Për të mbrojtur pjesën e tyre të tregut dhe për të siguruar performancën e stabilitetit financiar, bankat zgjeruan rrjetin e tyre, futën produktet e reja, përmirësuan cilësinë e shërbimeve dhe u angazhuan edhe më shumë në aktivitetet e kthimit të lartë. Kjo praktikë e zgjerimit të aktiviteteve çoi në një përdorim më efikas të burimeve të tyre financiare, duke ndikuar në vazhdimësi edhe në zvogëlimin e kostos së ndërmjetësimit financiar BQK (2011).

² J. Edward Ketz (2003) - Hidden Financial Risk Understanding Off-Balance Sheet Accounting, Washington fq.129.

³ McMillan J. (2014), The End of Banking: Money, Credit, and the Digital Revolution, Zurich.

Por ky zgjerim është ngadalësuar me fillimin e krizës financiare globale. Problemet filluan të shfaqen sidmos në tregun e kredive, ku kredi jo performuese në vitin 2003 ishin në vetëm 1.9 përqind të gjithsej kredive, ndërsa në fund të vitit 2013 arritën në 8.7 përqind të gjithsej kredive BQK (2013).

Që nga shfaqja e saj në vitin 2007 kriza financiare globale ka nxitur zhvillimin e debateve ekonomike. Ajo është bërë temë kryesore diskutimi në qarqet akademike dhe në shumicën e forumeve ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe samiteve të organizuara nga vendet e G7, G10, G20, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.

Duke u bazuar në mungesën e hulumtimeve rreth kësaj teme të rëndësishme për sektorin bankar, uroj që ky punim të jetë një nismë për hulumtime tjera që do të bëhen në të ardhmen. Ky punim synon të ndihmojë ekzekutivit të bankave dhe drejtuesve të departamentit për menaxhimin e kredive që ta kenë më të qartë situatën aktuale, sfidat dhe problemet e implementimit të menaxhimit të efektshëm kreditorë.

Ky punim do të kontribuojë edhe te hulumtuesit tjerë shkencorë që të njihen me sfidat e menaxhimit të kreditve të sektorit bankar të Republikës së Kosovës dhe mundësitë e krijimit të një ambienti të shëndoshë të menaxhimit të kredive në përgjithësi.

Në këtë punimë do të analizojmë aktivitetet kryesore te bankave komerciale me theks te vecant te Bankes Ekonomike në tregun bankar të Kosovës duke i analizuar më detajisht mënyrat e kreditimit që keto banka i përdorin për NVM-të në Kosovë, rreziqet të cilat u kanosen si dhe veprimet që ajo i ndërmerr për ti anashkaluar ato, një analizë e bilancit të saj, si qëndron ajo me likuiditet, raportet me kapitalin si dhe tregusit kryesorë të profitabilitetit.

Banka Ekonomike është njëra ndër bankat e para në Republikën e Kosovës e cila është licencuar më 28.05.2001, ndërsa punën e ka filluar në fillim të qershorit të po këtij viti. Nga momenti i licencimit, Banka Ekonomike, ka pësuar ndryshime të rëndësishme, në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe është banka e vetme me 100% kapital vendor.

Banka Ekonomike është atraktive për të gjithë klientët e saj me kushtet e veqanta të cilat i ofron si për individë po ashtu edhe për biznese. Duke filluar me llogari, ku mund të hapen llogarit në katër valuta të ndryshme si EUR, USD, CHF dhe GBP dhe me të gjitha shërbimet elektronike më të avancuarat në vend. Depozitat më atraktive në sektorin bankar me dy mundësi: Rrafatizim i kapitalit + kamata dhe Afatizim vetëm i kapitalit, ndërsa kamata bartet në llogari rrjedhëse.

Po ashtu edhe për kredi është banka e cila ofron mundësitë më të volitshme me produktet e larmishme kreditore si: Kredi për mikrobiznese, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, mbitërheqje, garancione, letër kredit etj.

3. Sektori bankar në Republikën e Kosovës

3.1. Sistemi bankar në Kosovë – Aspekte historike

Është një fakt i njohur që bankat luajnë disa role në çdo ekonomi. Dhe këto role kanë për qëllim sigurimin e sistemit të shëndoshë financiar dhe stabilitetin ekonomik. Është e padiskutueshme se sistemi bankar është motori i rritjes në çdo ekonomi, duke pasur parasysh funksionin e tij të ndërmjetësimit financiar. Ndërmjet këtij funksioni, bankat në mënyrë të lehtësuar formojnë kapitalin dhe bëjnë promovimin e rritjes ekonomike (Omankhanlen, 2012).

Gjatë epokës socialiste, në të gjithë rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) ekzistonte një sistem monobankë. Me reformën e sektorit bankar pas vitit 1990, këto vende shfuqizuan ish-sistemin monobankë dhe themeluan të ashtuquajturin sistem bankar me dy nivele, i cili është tipik për ekonominë e tregut⁴. U zbatua konsolidimi i bankave komerciale dhe privatizimi nga investitorët e vendit dhe të huaj.

Me pjesëmarrjen e bankave të huaja, shërbimet e reja janë futur në një kohë të shkurtër në këto vende dhe, në krahasim me sistemin monobankë të epokës socialiste, praktikat e menaxhimit të riskut të bankave dhe efikasitetit financiar janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme (Banincova, 2012).

Ritmi i shpejtë i zgjerimit të kredive në vendet e EQL-së, në përgjithësi nga një bazë e ulët, është e mundur të jetë nxitur nga një proces “zëre hapin”. Në përgjithësi, kjo tendencë është parë si një pasojë normale dhe pozitive e shkallës së rritjes, themelimit dhe ristrukturimit.⁵ Nga ana e ofertës, institucionet e huaja financiare, që hyjnë në këto tregje me qëllim të fitimit të shpejtë të tregut, shpesh kanë lehtësuar financimin në zgjerimin e shpejtë të kredisë. Risku i rritjes së shpejtë të kredive është nënvlerësuar, për shkak të vështirësive të matjes së parashikimeve të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik dhe lidhjes së tij me humbjet e kredisë. Si rezultat i kësaj, janë ndërmarrë masat e kujdesshme dhe mbikëqyrëse për të frenuar rritjen e kredisë (Hilbers, Robe, Pazarbasioğlu, Johnsen, 2005).

Periudha e procesit të tranzicionit që filloi rreth vitit 1990 - 1999 të shekullit XX, shkaktoi rënien e sistemit socialist në Evropën Qendrore dhe Lindore. Shpërbërja e Jugosllavisë dhe futja e Kosovës në administrimin e dhunshëm të Serbisë e ka shkatërruar Sistemin ekonomik dhe atë bankar edhe ashtu të pa qëndrueshëm që e kishte Kosova në kuadër të ish shtetit Jugosllav.

⁴ Simpson S.D. (2010), *The Banking System*, fq. 156, Sydney.

⁵ Safet Merovci (2004) “Tregjet dhe instrumentet financiare” fq.89, Prishtinë.

Sistemi bankar kosovar është një sistem relativisht i ri, por që pas vitit 1999, ka shfaqur një zhvillim të shpejtë duke u transformuar krejtësisht, nga një sistem i drejtuar nga sistemi bankar me pronësi shtetërore në ish Jugosllavi, në një sistem bankar me pronësi private pas çlirimit.

Ky sistem bankar përbëhet nga banka qendrore (Banka Qendrore e Kosovës), bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Struktura institucionale është e larmishme si: Banka Komerciale, Kompani të Sigurimit, Fonde të Pensioneve, Institucione Mikrofinanciare, Asociacione Kreditore dhe Institucione Financiare jo bankare, të licencuara dhe të mbikqyrura nga BQK.⁶

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës u siguron institucioneve publike, komunitetit financiar dhe publikut shërbimet e rëndomta financiare që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të çfarëdo krediti ose likuiditeti të përkohshëm meqë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk është bankë emetuese. **Valuta që përdoret në Kosovë është Euroja.**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për sigurimin e një furnizimi të duhur të Kosovës me kartëmonedha dhe monedha euro, për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Meqë euroja është valuta kryesore e lejuar për përdorim në Kosovë, përgjegjësitë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë me euron.⁷

Meqenëse sistemi bankar luan një rol kyç në përgjithësi në ekonominë e një vendi, cilësia jo e mirë në mbikëqyrjen e këtij sistemi mund të jenë me pasoja të rënda në sistemin bankar dhe ekonominë e çdo vendi. Synimi i secilit vend është që të kenë një mbikëqyrje efektive të bankave të nivelit të dytë nga ana e autoriteteve rregullative, respektivisht nga Banka Qendrore (BQ), sistemi bankar mund të bie pre e një risku të tepruar, si risku moral dhe korupsionit.

Mbikëqyrja efektive e bazuar konform rregullativës së Komitetit të Bazel-it, ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga BQK-ja, për rregullimin dhe mbikëqyrjen bëhet për të siguruar stabilitetin e sistemit financiar dhe përmes tij të ndikojë në vazhdimin e rritjes ekonomike.

Mbikëqyrja fokusohet në çështjet themelore të sistemit bankar në atë se: a kanë bankat kapital adekuat sipas rregullativës, asetet likuide për zhvillimin e aktiviteteve në të ardhmen, cilësinë e aseteve dhe burimet adekuate për të mbuluar riskun e perceptuar, qeverisjen korporative të mirë bazuar në standardet ndërkombëtare "praktikave të mira", në menaxhimin e aktiviteteve të tyre dhe ushtrimin e afarizmit të tyre në mënyrë që të mos e dëmtojnë klientët dhe publikun nëpërgjithësi.

Bankat komerciale kryejnë veprimtaritë e tyre në mënyrë të pavarur, përfitim në parimet e aftësisë së pagesës, rentabilitetit dhe të sigurojnë likuiditetin.

⁶ Roli i sistemit bankar dhe zhvillimi ekonomik – Kastriot Gjocaj, Ibish Mazreku, Ardita Gashi ,

⁷ Banka Qendrore e Kosovës – <http://bqk-kos.org/index.php?id=27> ,

Sistemi bankar i Kosovës përbëhet nga banka komerciale me kapital privat të huaj e të përbashkët dhe me kapital privat të përbashkët vendor. Në dhjetë vitet e kaluara, bankat komerciale janë ballafaquar me një sërë problemesh. Karakteristikë ka qenë shkalla e ulët e ndërmjetësimit të tyre dhe marrëdhënie të kufizuara me klientët (biznese e individë).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucioni financiar kryesor i vendit, e cila punon në përputhje me Ligjet në fuqi, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Bankat e nivelit të dytë janë bankat komerciale, të cilat ekzekutojnë politikat dhe shërbimet e sistemit financiar. Banka komerciale në Kosovë janë; Banka për Biznes, Banka Ekonomike, ProCredit Banka, Raiffeisen Banka, Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë - Dega në Kosovë, TEB – Kosove, Banka Komerciale e Beogradit Dega në Mitrovicë, NLB Prishtina dhe IS Banka.

Bankat komerciale në Kosovë ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme, e ndër më të rëndësishmet janë: llogarite bankare, transferet e parave, depozitat me interes, kredi të ndryshme, kartelat bankare, interneti bankar etj.

3.1.1. Struktura e menaxhimit në sistemin bankar

Organet që administrojnë sistemin bankar në një bankë komerciale janë:

Asambleja e aksionarëve; Këshilli drejtues; Komiteti i kontrollit (Auditimi); Bordi i drejtoreve, në krye me Drejtorin Ekzekutiv (CEO); Menaxheret e departamenteve; Menaxheret e degëve; Stafii në linjen e parë, stafii administrues dhe stafii mbështetës⁸

Asambleja e aksionareve: Asambleja e aksionareve është organi më i lartë i një institucioni / banke, i cili e mbikqyr punën e bordit të drejtoreve. Kjo asamble është organi që i përcakton rregullat, organizimin, politikat dhe procedurat se si duhet udhëhequr bankën. Po ashtu, përcakton objektivat dhe bënë selektimin e bordit të drejtoreve.

Përbërja e këshillit drejtues: Këshilli drejtues është organ vendimmarrës dhe mbikëqyrës. Këshilli drejtues përbëhet nga një numër tek individësh, jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë anëtarë. Këshilli drejtues zgjedh nga gjiri i tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, që ngarkohen me mbledhjen e këshillit dhe drejtimin e debatit gjatë seancave të tij.

Anëtarët e këshillit drejtues emërohen nga asambleja e aksionarëve për një periudhë jo më të gjatë se 4 vjet dhe kanë të drejtë të rizgjidhen për të njëjtin mandat pa kufizim. Anëtarët e parë të këshillit drejtues caktohen në statut.

⁸ Sulo Haderi (2003) "Paraja, bankat dhe tregjet financiare" (Ekonomia monetare), Tiranë.

Të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit drejtues duhet të zgjidhet nga individë, të cilët në çastin e zgjedhjes dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash privatë, me bankën, aksionarët që ushtrojnë kontroll mbi bankën ose me drejtuesit e saj ekzekutivë.

Anëtarët e këshillit drejtues mund të shkarkohen në çdo kohë nga asambleja e zakonshme e aksionarëve.

Në rast bashkimi ose ndarjeje, emërimi i anëtarëve të këshillit drejtues bëhet nga asambleja në një mbledhje të jashtëzakonshme të saj.

Anëtarët e drejtorisë mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues, me kusht që numri i përgjithshëm i tyre të mos përbëjë shumicën e të gjithë anëtarëve të këshillit drejtues.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit drejtues nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të drejtorisë.

Anëtarët e këshillit drejtues, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, drejtohen nga standardet më të larta të etikës dhe vepronë duke u mbështetur në informacion të plotë dhe të mjaftueshëm, në mirëbesim, me kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur, me përkushtim të plotë ndaj përgjegjësive të tyre dhe në interesin më të mirë të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së veprimtarisë bankare dhe financiare të klientëve dhe aksionarëve të tyre.

Komiteti i kontrollit (Auditimi) : Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionarëve për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e komitetit të kontrollit janë individë, të cilët duhet të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në fushën e kontabilitetit ose auditimit.

Komiteti i kontrollit ka këto detyra:

- kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka Qendrore,
- kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
- shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
- propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;

- bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
- kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet këshillin drejtues të bankës;
- i jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit;
- miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

Komiteti i kontrollit mbledhet jo më pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli drejtues i bankës. Vendimet merren me shumicë votash e të gjithë anëtarëve.

Anëtarë të komitetit të kontrollit nuk mund të jenë punonjës ose drejtues ekzekutivë të bankës. Anëtarët e komitetit të kontrollit mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues.

Komiteti i kontrollit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund tëndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

Komiteti i kontrollit raporton përpara këshillit drejtues dhe e ndihmon këtë të fundit në vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e bankës.

Auditimi i brendshëm: Banka ose dega e bankës organizon sistemin e kontrollit të brendshëm, me qëllim monitorimin e zbatimit të politikave dhe procedurave të brendshme, vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë bankare dhe monitorimin e përputhshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore.

Qëllimi i kontrollit të brendshëm është të identifikojë ekspozimin e bankës ose degës së bankës ndaj llojeve të rreziqeve, matjen, administrimin dhe monitorimin e nivelit të tyre.

Sistemi i kontrollit të brendshëm të bankës ose degës së bankës së huaj përbëhet nga një tërësi procedurash, rregullash dhe strukturash, të cilat ekzistojnë brenda saj.⁹

Banka krijon njësinë e kontrollit të brendshëm, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo njësi ka për qëllim të sigurojë një kontroll efektiv të zbatimit të politikave, të rregulloreve dhe procedurave të miratuara nga këshilli drejtues ose drejtoria për degën e bankës dhe të sigurojë saktësinë e informacionit dhe efektivitetin e masave parandaluese ndaj rreziqeve, me të cilat përballlet banka.

Këshilli drejtues përcakton rregullat e funksionimit dhe ushtrimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm emërohen nga këshilli drejtues i bankës dhe raportojnë në organet përkatëse të bankës, sipas mënyrës së përcaktuar nga këshilli drejtues.

⁹ H. Ismaili (2003) – KontrollidheRevizioni – Ligjeratatë e Autorizuara, Prishtinë, fq.39

Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm të degës së bankës së huaj emërohen nga organet vendimmarrëse të bankës. Punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm nuk mund të kenë asnjë funksion tjetër në bankë ose në degën e bankës.

Raportet financiare: Banka mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së saj financiare, mbi baza individuale ose të konsoliduar.

Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Banka e Qendrore kërkon që çdo bankë dhe degë e bankës të huaj të kenë procedura drejtimi, kontabiliteti dhe mekanizma të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale ose të konsoliduar, në përputhje me aktet nën ligjore të Bankës Qendrore. Banka Qendrore përcakton formën, tipin, metodologjinë, përmbajtjen e raporteve dhe kohën e raportimit të bankave ose degëve të bankave.

Bordi i drejtorve – Drejtori ekzekutive dhe drejtuesit ekzekutivë: Ushtrimi i veprimtarisë së bankës dhe i degës së bankës drejtohet dhe organizohet në mënyrë të vazhdueshme nga bordi Ekzekutivë në krye me drejtorin ekzekutivë.

Bordi i drejtoreshave përbëhet nga një ose më shumë drejtues ekzekutivë - menaxher. Drejtori gjeneral i raporton bordit të drejtoreshave.

Menaxheret e departamenteve: Eshtë e kuptueshme që çdo bankë e ka të organizuar strukturën menaxhuese në departamente dhe dege. Numri i departamenteve varet kryesisht nga madhësia e bankës. Disa banka i kanë një numër të vogël të departamenteve, si: departamentin për persona private, departamentin për persona juridike, si dhe ndonjë departament tjetër, kurse disa banka e kanë të organizuar skemën në më shumë departamente, si departamentin e kartelave, riskut operacional, riskut kreditor, etj. Menaxheri i departamentit është përgjegjës për zhvillimin, udhëheqjen, raportimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave që janë në përgjegjësi të departamentit të tij.¹⁰

Menaxheret e degeve: Roli i degeve në bankë është shumë i rëndësishëm. Dega është linja e parë me të cilën ndeshet klienti, andaj edhe bërë kryesore për zhvillimin e biznesit bërë në dege. Menaxheret e degeve janë përgjegjëse për zhvillimin e biznesit, monitorimin e stafit dhe politikave e procedurave që duhet zbatuar, raportimin në zyrën qendrore, zhvillimin e stafit, etj.¹¹

¹⁰ Simpson S.D. (2010), The Banking System, Sydney.

¹¹ G. Luboteni, (2008) "Menaxhmenti Bankarë", Prishtinë ,

3.2. Roli i sistemit bankar në përkrahjen e NVM-ve

Sistemit bankar ne Kosovë para luftime karakterizohet nga një kontroll i forte i qeverisë qendrore ne te gjitha aspektet e sistemit. Pavarësisht nga rrjeti i përhapur (i shtrire gjerësisht) i sistemit bankar, i cili ishte ngritur duke u përqendruar kryesisht ne kujdesin e mekanizmave shtetëror, sistemi bankar ne Kosovë i periudhës se komunizmit ne ish Jugosllavi, drejtohet gjerësisht nga mekanizmat e qeverise dhe shtetit.

Sistemi ishte tepër i centralizuar, ku Ministria e Bankave dhe financave rregullonte te gjitha shërbimet bankare ne vend dhe vendoste për shpërndarjen e burimeve dhe emërimin e personelit te menaxhimit. Shkatërrimi i shtetit te ish Jugosllavisë dhe futja e Kosovës nen administrimin e dhunshëm te Serbisë e dëmtuan rend sistemin bankar ne Kosovë.

Dhuna dhe lufta sollën si pasoje një dëmtim te madh te ekonomisë, sistemit financiar, infrastrukturës te sistemit bankar dhe ndërprerjen e veprimtarisë te shume bankave dhe filialeve neper qytetet e Kosovës. Asetet e këtyre bankave u plaçkiten dhe u shkrinë ne disa banka te Serbisë te cilat punonin për interesin e regjimit shtetëror. Pothuajse i gjithë personeli shqiptar qe punonte ne at kohe ne bankat dhe filialet qe shtriheshin brenda territorit te Kosovës, u larguan ne mënyrë te dhunshëm nga vendet e punës.

Një serë reformash sektoriale u nisen pas vitit 2000, mirëpo për këto vite është bere shume pak progres për çuarjen përpara te Sistemit Bankar dhe avancimin e shërbimeve bankare. Qeveritë e Kosovës gjate këtyre 12 viteve, edhe pse pa kompetenca ose me kompetenca te kufizuara, kanë nisur një serë reformash për te filluar trajtimin e disa dobësive te Sistemit Bankar ne Kosove ne periudhat e pas luftës.

Përmes këtyre reformave, synohet që të arrihen këto objektiva strategjike:

- ulja e shkallës së nivelit te kredive te këqija përmes ngritjes së kualitetit të shërbimeve bankare në vend sipas standardeve bashkëkohore dhe sugjerimeve te FMN-es
- përmirësimi i menaxhimit të resurseve bankare ekzistuese dhe ngritjes së cilësisë te shërbimeve bankare.
- sektori i Sistemit Bankar ne Kosovë përbëhet nga shumë institucione të veçanta – Banka afariste, të cilat, krahas asaj që të sigurojnë ofrimin e shërbimeve bankare efektive, duhet të funksionojnë si një sistem I integruar bankar ne zhvillimin e ekonomisë se vendit.
- një kusht fundamental është një qartësi më e madhe e roleve dhe përgjegjësisve të bankave komerciale që të ndihmojnë në eliminimin e konfuzionit, ngritjen e llogaridhënies dhe përmirësojnë eficiencën.
- funksionalizimi, riorganizimi dhe plotësimi i infrastructures ekzistuese të sistemit bankar dhe sigurimi i kredibilitetit bankar në përputhje me standardet Evropiane.
- implementimi dhe zhvillimi i sistemit të informimit për shërbimet bankare si një sistem që mbledh, analizon, ruan dhe shpërndan informacionet me kohë në një formë të standardizuar, sistem ky i dobishëm për vendimmarrje në kujdesin shërbimeve bankare dhe për organizimin e kujdesit shërbimeve bankare në të gjithë nivelet.
- krijimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin e ekonomisë.

Të gjitha këto janë prioritete bazike dhe kahe të domosdoshme për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm bankar ne Kosovë i cili do të ketë rol të rëndësishëm ne zhvillimin ekonomik dhe do të ofroj shërbimecilësore bankare të nivelit të lartë dhe të njohur ndërkombtarisht.

Ekspertë dhe menaxherë te Bankave Komerciale, duhet te bëjnë reforma gjithëpërfshirëse, te cilat duhet te jene themel i një strategjie, që do të fillojë ta vendos Sistemin e Bankar ne Kosovë në binarët e duhur, drejt përmirësimit të situatës qe ekziston.

Gjendja momentale e sistemit bankar

Këto 12 vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka bërë ndryshime të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore që kanë ndikuar thuajse në të gjithë aspektet e jetës ne Kosovë, përfshirë këtu edhe rezultatet e shërbimeve bankare. Pavarësisht nga njëfarë përparimi që është bërë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, gjendja e sistemit bankar ne Kosovë mbetet nën atë të shumicës së vendeve të tjera të rajonit.

Për më tepër, vitet e tranzicionit kanë çuar në ndryshime të theksuara të mënyrës së jetesës dhe përmirësimit te gjendjes financiare te popullsisë se Kosovës. Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve bankare po bëhet aq shpejtë sa që shpesh klientët duket se janë të hutuar nga shumë llojshmëria e produkteve financiare të cilat ofrohen.

Shumë banka konsiderohen shpesh si institucione misterioze ose thjesht si institucione të cilat zhvillojnë biznes me shumë leverdi, prandaj edhe transparenca është e domosdoshme. Me qëllim të zhvillimit të konkurrencës së shëndoshë, si dhe për t'ia lehtësuar punën kredi marrësve, bankat komerciale kanë zhvilluar projekte me tabelat krahasuese për shume lloje te kredive të ofruara si Kredi Personale, Kredi Biznesi, Kredi për Shtëpi, Kredi Hipotekare, Agro Kredi, Auto Kredi, si dhe shume lloje te llogarive për depozita.

Që efekti i kredive, e sidomos i kredive në sektorin privat, të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik, është i nevojshëm përmirësimi i institucioneve në përdorimin e instrumenteve të reja financiare të kreditimit. Gjithashtu, edhe rritja e konkurrencës në industrinë bankare do të lehtësonte qasjen e firmave ndaj kredive.

Gjatë hulumtimit është vërejtur se ekzistojnë dallime në ofertat e ndryshme të bankave në tregun tonë, edhe pse jo çdo herë në normat interesit por në pikat tjera të ofertës të cilat janë gjithashtu shumë të rëndësishme si p. sh. maturiteti, penalit, kostot administrative, kohë zgjatja për marrje ne kredisë etj.

Për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar burime të ndryshme për marrje te informacioneve të nevojshme, në mënyrë që ato të jenë sa më të sakta dhe kredibile. Bashkëpunimi i drejt për drejt me Institucionet Bankare si qëllim primar ka qenë që të gjithainformacionet e nevojshme për analizë rreth punimit, të sigurohen në mënyrë zyrtare, duke i kërkuar ato nga bankat gjegjëse.

Marrja e një kredie në një bankë apo institucion tjetër kredi dhënës, është një proces që i nevojitet kohë, analizë dhe e cila përcillet nga disa kushte të përgjithshme që duhen plotësuar nga kredi marrësi. Njohja e këtyre kushteve është një domosdoshmëri thelbësore e sidomos mundësia e krahasimit të këtyre shërbimeve/produkteve ndërmjet bankave e cila më pas ofron mundësinë e përzgjedhjes së bankës që i përshtatet interesave të kredi marrësit, përfshirë çmimin, shpejtësinë, profesionalizmin, sigurinë, transparençën, etj.

3.3. Politikat bankare dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës

Ajo çfarë i dallon bankat nga të gjitha institucionet e tjera financiare dhe jofinanciare dhe i bën si ndërmarrje specifike “sui generis” është fakti se këto institucione kryejnë funksionin e ndërmjetësimit financiar. Pra, ndërmjetësojnë ndërmjet sektorëve ekonomikë, të cilët kanë tepriçë të mjeteve financiare dhe të njëjtat mjete i transmetojnë te sektorët ekonomikë të cilët kanë mungesë të mjeteve financiare.

Sipas hulumtimeve të fundit, aktiviteti ekonomik i një vendi nuk mund të paramendohet pa kredi. Që të realizohet ky qëllim, është me rëndësi që niveli i kredive t'i përgjigjet rritjes së procesit të riprodhimit në mënyrë të vazhdueshme dhe mjetet të huazohen në sektorë ekonomikë, të cilët llogariten si katalizatorë të përshpejtimi të rritjes ekonomike.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mundësinë e qasjes në financa në tregjet financiare e kanë shumë të kufizuar, kështu që rritja dhe zhvillimi i tyre është shumë i varur nga qasja e kredive në industrinë bankare jo vetëm në vendet në zhvillim por edhe në ato të zhvilluara. Kreditë për mjete qarkulluese (si blerja e lëndës së parë, gjysmë-produkteve apo produkteve të gatshme), kontribuojnë në ekspansionin e tyre, sidomos te ndërmarrjet e reja të sapoformuara.¹²

Politikat bankare për stabilitet financiar dhe zhvillim ekonomik duhet te bazohen ne tri kahe kryesore te menaxhimit te cilat duhet te kenë si objektiv:¹³

- Zbatimin e politikave parandaluese qe përfshijnë masat paraprake të cilat synojnë reduktimin e kostove potenciale të destabilizimit financiar. Disa nga këto politika përfshijnë krijimin e infrastrukturës ligjore të shëndetshme për zbatim nga ana e institucioneve financiare, të rregullimeve bankare për drejtimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

- Zbatimi i politikave administruese qe janë masa të cilat synojnë kapërcimin e pa qëndrueshmërisë financiare ose zbutjes së ashpërsisë së tyre kur ato ndodhin. Këtu përfshihet një nga lehtësitë e ofruara nga banka qendrore, lehtësi e cila mbron institucionet financiare të shëndetshme nga mungesat e likuiditetit. Marrja në kohë e masave të duhura ndaj dobësisë së institucioneve financiare, kufizon kostot që rrjedhin si rezultat i paqëndrueshmërisë.

- Zbatimi i politikave rehabilituese për minimizimin e kostove që rrjedhin pas një destabilizimi financiar. Ato përfshijnë ristrukturimin e institucioneve të dëmtuara financiarisht nëpërmjet masave të ndryshme si rikapitalizimi, bashkimi me institucione si motra te suksesshme, ndërrimi i ekipit drejtues të institucionit etj. Këto masa janë të orientuara drejt reduktimit të kostove të paqëndrueshmërisë financiare të cilat rrjedhin nga dëmtimi i një pjese të sistemit financiar.

Disa rekomandime me qëllim të rritjes së stabilitetit financiar ne sistemin bankar:

- Rritja dhe zhvillimi i sektorit bankar (2000-2010) është shoqëruar me krijimin e bankave dhe rritjen e numrit te tyre, me zgjerimin e produkteve të ofruara, me zgjerim të shtrirjes gjeografike duke mbuluar të gjithë territorin të vendit. Edhe pse konstatohet një përpjekje e vazhdueshme e operatorëve bankarë për sigurimin e një baze të gjerë klientëve duke rritur konkurrencën, kjo rritje ende nuk ka

¹² Bullivant G. (2012), Credit Management, fq 58 London,

¹³ Levine, R. (1997). Financial Development, Economic Growth: Views and Agenda. Journal of Economic Literature, Boston.

pasur efekte të konsiderueshme në uljen e normave të interesit në kredi si dhe zvogëlimin e dallimit në mes interesit në kredi dhe depozitave i cili është i lartë.

- Kapitali i bankave ekzistuese dominohet nga kapitali i huaj dhe përqindja e kapitalit vendor është e ulët, ndihet nevojë që të bëhet rritja e bankave të reja dhe shtrirje e tyre në tërë vendin.

- Duhet të bëhet liberalizimi i tregut bankar përmes licencimit të bankave të reja, përkatësisht duhet të rritet numri i bankave që operojnë në Kosovë;

- Asimetria e informacionit, e shprehur në pamundësinë kryesisht të klientëve individë dhe bizneset e vogla për të gjetur një informacion të përmbledhur, krahasues të azhurnuar për të gjitha bankat, për të siguruar gjithë informacionin e nevojshëm nga bankat për të bërë zgjedhjet e tyre. Kjo vjen pjesërisht nga aftësitë e kufizuara të tyre për të përpunuar informacionin dhe pjesërisht nga mungesa e informimit efektiv që japin bankat. Kjo e bën zgjedhjen e produktit dhe të ofruesit të tij më të vështirë për konsumatorët dhe redukton presionin e bankave për të konkurruar me çmimet, të paktën për produkte të caktuara ose për cilësinë e shërbimit.¹⁴

- Mungesa e transparencës, e paraqitur më qartë përmes pamundësisë së konsumatorëve për të krahasuar në mënyrë efikase shërbimet e ofruara nga Bankat ka kontribuar në një nivel të ulët të mundësive të konsumatorëve për të lëvizur. Këto rrethana i krijojnë mundësinë ofruesve të rrisin çmimet mbi nivelin konkurrues të tregut pa humbur pjesë tregu. Për më tepër procesi i ndërrimit të Bankës është për konsumatorin një proces i vështirë, i kushtueshëm dhe zakonisht kërkon kohë. Mungesa e informimit të klientin detyron atë të ngelet i “bllokuar” në një bankë të caktuar dhe “kostot e tranferimit” për te të jenë më të larta.

- Në kushtet e një tregu paraje jo shumë aktiv dhe pothuajse mungesës së tregut të kapitaleve, depozitat nga klientët vazhdojnë të mbeten burimi parësor i gjenerimit të fondeve në sistemin bankar. Me gjithë rënien e shkallës së përqendrimit të tyre tek ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank, ato zotërojnë rreth 68% të tregut dhe do të ishte me interes të analizoheshin normat e interesit që ofron për depozitat (të ultë) dhe interesat në kredi (të lartë) vlerësimin e tyre si një strategji e menaxhimit të likuiditetit apo abuzim?

- Fuqia e bankave në tregun e kredive ku dhe konkurrenca është më e fortë, mund të thuhet se “ndahet” ndërmjet bankave. Në përgjithësi ato ruajnë një marzhë të lartë fitimi, krahasuar me kostot (interesin bazë), me agresivitet ose tërheqje nga tregu. Këtu, do të ishte shumë e vlefshme, analiza e strukturës së portofolit të kredisë sipas nënprodukteve. Kështu, një gamë e rritur e nënprodukteve dhe mungesa e të dhënave analitike e bëjnë analizën dhe nxjerrjen e konkluzioneve jo të saktë.

- Një proces interaktiv i letrave me vlerë të Qeverisë dhe fondeve të kursimit, agjencive të sigurimit, do të luante një rol të rëndësishëm në zbutjen e pozitës dominuese të Bankave komerciale në këtë treg. Kjo krijon konkurrencë dhe presion për më shumë transparencë dhe informacion.¹⁵

- Mungesa e Ligjit për Letrat me vlerë si dhe nxjerrja e tij do të duhet të bëhet menjëherë në mënyrë që të hapet rruga për funksionin e tregut të letrave me vlerë, me çka do të rritej hapësira e investimeve kapitale etj

¹⁴ Dunn M. (1998), The Credit Policy Workbook: a step-by-step, easy, fill in the blanks guide (The Collecting Money Series Book 5), fq, 137 Washington

¹⁵ Richard A. Brealey, Stewart C. Myers, Alan J. Marcus (2014) - Fundamentals of Corporate Finance, fq.47 London.

4. Potenciali kreditues i sektorit bankar në Republikën e Kosovës (2007-2016)

4.1. Struktura e aktiveve dhe burimeve të aktiveve të industrisë bankare në Kosovë

Në Kosovë sot operojnë gjithësej dhjetë banka komerciale, ku gjatë vitit të kaluar mori licencë edhe banka e dhjetë komerciale. Industria bankare në Kosovë përbën 70.8% të gjithësej aseteve të sistemit financiar. Andaj ky numër do të trajtoj njërin prej përbërësve kryesor të sistemit financiar. Ekonomia e Kosovës konsiderohet të jetë relativisht e re por e karakterizuar me një zhvillim më të shpejtë të sistemit financiar. Në këtë rrafsh edhe industria bankare vazhdimisht është rritur, me ç'rast në fund të vitit 2014 kishte arritur lerën e aseteve në 3.186.8 milion euro.¹⁶




Fig.1 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Asetet e industrisë bankare kanë shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, duke u bërë kështu bartëse e zhvillimit ekonomik në vend. Nëse shikohet në periudha më afatgjate, pra brenda një periudhe katër vjeqare (2010-2014), atëherë asetet e kësaj industrie janë rritur për 29.8%.

STRUKTURA E ASETETEVE TË INDUSTRIJË BANKARE					
	Milion euro				
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	454.2
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	383.8
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.5
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.7
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,186.8

Tab.1 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

¹⁶ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes dhe korporatave tjera depozituese - <http://bqk-kos.org/?id=55>

Struktura e asetëve të industrisë bankare siç shihet edhe në tabelën 1 është dominuar nga kreditë dhe lizingu, pastaj nga paraja e gatshme dhe bilanci me BQK, bilanci me bankat komerciale dhe letrat me vlerë.




Fig.2 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Në figurën 2 mund të shohim se vlera e kredive dhe lizingut në fund të vitit 2010 ishte 1,458.7 milion euro, çka nënkupton se brenda një periudhe katër vjeqare vlera e kredive dhe lizingut është rritur për 29%, nëse krahasohet periudha 2010 – 2014.¹⁷ Kjo tregon se vlera e tyre ishte rritur në proporcion të njëjtë me rritjen e gjithësej asetëve të industrisë bankare, çka nënkupton se kreditë dhe lizingu ishin përbërësit kryesor të kësaj rritjeje. Rritje e ndjeshme në kuadër të kësaj strukture të asetëve kishin shënuar edhe letrat me vlerë, me ç'rast brenda një periudhe katër vjeqare renditet e treta në përbërësit e asetëve së bashku me bilancin me bankat komerciale në kuadër të gjithësej asetëve të industrisë.

Përbërësi i dytë për nga vlera e strukturës së asetëve të industrisë bankare ishte paraja e gatshme dhe bilanci me Bankën Qendrore të Kosovës e cila gjithashtu ka shënuar rritje në strukturën e asetëve, me përjashtim në vitin 2014 kur kjo vlerë u zvogëlua në 14.3%. Pas kësaj rradhiten letrat me vlerë, bilanci me bankat komerciale, asetet fikse dhe asetet tjera.

PJESËMARRJA NË STRUKTURËN E ASETËVE TË INDUSTRIJË BANKARE					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.3%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.0%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab.2 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

¹⁷ Banka qendrore e Kosovës, raportet e sistemit bankarë në Kosovë (2010-2014), Prishtinë.

Në tabelën 2, mund të vërehet se struktura e gjithësej asetëve të industrisë bankare ishte dominuar nga kredite dhe lizingu, megjithëse kjo në tri vitet e fundit ka një tendencë të lehtë të uljes në kuadër të gjithësej asetëve. Rritje kishin shënuar paraja e gatshme, me përjashtim të vitit të fundit, bilanci me bankat komerciale në dy vitet e fundit dhe sidomos letrat me vlerë gjat gjithë kësaj periudhe krahasuese.



Fig.3 dhe 4 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave ndërmjet vitit 2010 dhe vitit 2014, sikurse janë paraqitur në figurën 3 dhe 4, mund të shohim se kredite dhe lizingu shprehur në përqindje në kuadër të asetëve të industrisë bankare kishte mbetur afërsisht e njëjtë në gjithësej strukturën e asetëve, përderisa bilanci me bankat komerciale kishte shënuar ulje. Rritje të ndjeshme në këtë përbërje kishin shënuar letrat me vlerë. Pra marrë në përgjithësi në kuadër të kësaj periudhe krahasuese, përbërja e asetëve të industrisë bankare nuk ka ndryshuar shumë dhe ishte e dominuar nga kredite dhe lizingu që bankat kanë lëshuar për klientët e tyre dhe lëvizjet e vogla të përbërësve tjerë të asetëve, kryesisht të letrave me vlerë.

RRITJA/ZVOGËLIMI VJETOR I STRUKTURËS SË ASETËVE TË INDUSTRIËS BANKARE				
Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	8.0%	28.4%	8.8%	-2.0%
Bilanci me bankat komerciale	-25.0%	-12.6%	18.1%	12.9%
Letrat me vlerë	16.4%	27.0%	38.2%	8.3%
Kredite dhe lizingu	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%
Asetet fikse	7.6%	21.7%	-3.7%	-3.2%
Asetet tjera	25.8%	-7.8%	5.6%	-28.6%
Gjithsej	7.9%	6.8%	8.1%	4.2%

Tab.3 Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së Korporatave Tjera Depozituese

Tabela 3 tregon lëvizjet në përqindje të rritjes apo zvogëlimit prej vitit në vit të gjithësej asetëve dhe përbërësve tjerë në kuadër të asetëve të industrisë bankare.

Gjithësej asetet e industrisë bankare kishin shënuar rritje të vazhdueshme, përderisa në fund të vitit 2014 kjo rritje ishte më e vogël në krahasim me vitet paraprake. Kredite dhe lizingu si përbërësi më i madh i strukturës së asetëve, gjithashtu kishte shënuar rritje, në të gjitha vitet krahasuese, megjithëse

kjo rritje në vitin e fundit ashtu sikurse gjithësej asetet ishte më e vogël në krahasim me periudhat tjera.

Asetet fikse, asetet tjera dhe paraja e gatshme ishin zvogëluar në fund të vitit 2014 në raport me vitin 2013. Një prej arsyeve se pse ka ndodhur kjo është se industria e bankare viteve të fundit është e orientuar më shumë tek avancimi dhe rritja në shfrytëzim të shërbimeve dhe produkteve elektronike, çka ka bërë që nevoja për prezencë fizike apo edhe për para të gatshme të jetë më e vogël në raport me periudhat e mëhershme, ndërkoh që vlerat tjera kryesore të strukturës së asetëve (siç janë kreditë) kanë shënuar rritje të vazhdueshme.

Kjo strategji e ndjekur nga industria bankare drejt zhvillimit dhe avancimit të teknologjisë elektronike është edhe në përputhje me strategjinë kombëtare të pagesave të hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

4.2. Shërbimet dhe produktet që ofrohen nga Bankat aktuale në Kosovë

Në Kosovë sot operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale dhe përbëjnë 69.0 përqind të asetëve totale të sektorit financiar. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Qasja në shërbimet e këtyre bankave mundësohet përmes aktualisht 263 degëve dhe nëndegëve, 540 ATM-ve dhe 9,493 POS dhe 196,656 llogarive e-banking.

Aktiviteti i tyre dominohet nga kreditë, afati i maturimit të cilave mund të jetë deri në 15 vjet, varësisht nga lloji i kredisë. Nga totali i kredive, 65.2 përqind janë kredi për ndërmarrjet. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (51.8 përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë (përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë dhe ndërtimtarinë) ka 23.0 përqind të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori i bujqësisë aktualisht përbën 4.0 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare është 34.4 përqind të gjithsej kredive.

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përfaqësojnë 80.2 përqind të gjithsej detyrimeve. Depozitat e sektorit bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind, duke arritur vlerën prej 2.7 miliard euro. Depozitat e sektorit bankar në Kosovë përbëhen nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 74.4 përqind të depozitave të gjithëmbarshme, përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 20.1 përqind.

Bankat komerciale në Kosovë kanë strukturë të ndryshme aksionare. Tetë prej tyre janë banka me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor. Numri i të punësuarve në bankat komerciale është rreth 3,337.

Bazuar në gamën e produkteve dhe shërbimeve që sot ofrohen nga bankat komerciale nuk është vështirë të vërehen, se cilat produkte janë gjithnjë të sforcuara dhe me prioritet të veçantë, duke synuar maksimizimin e fitimit -në rend të parë.

Në mënyrë shumë të qartë vërehet se të gjitha shërbimet –produktet e mëposhtme, kanë lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kreditim.

- Llogaritë: rrjedhëse, të kursimit, afatizuese...etj
- Depozitat: të individëve privat, ndërmarrjeve të ndryshme publike, shtetërore, private.
- Transferet e parave: brendshme, vendore, ndërkombëtare.
- Kanalet alternative: e-banking, m-banking...
- Kreditë personale: që iu dedikohen individëve / ekonomive familjare
- Mbitërheqjet/Flexi kreditë: Mbitërheqjet zbatohen për ekonomitë familjare dhe bizneset. Norma e interesit për mbitërheqjet bankare zbatohet kur llogaria rrjedhëse bëhet negative.
- Kreditë konsumuese: janë kreditë e dhëna për ekonomitë familjare me qëllim të përdorimit personal në konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Destinacioni i këtyre kredive është blerja e mallrave dhe shërbimeve të konsumit
- Kreditë me para të gatshme;Kreditë e mbuluara me para të gatshme lejohen duke bllokuar totalin e përgjithshëm nga mjetet e deponuara në llogari të veçantë dhe zberthyer si vijon:

$$\text{Totali} = \text{Shuma e kredisë} + \text{Interesi.}$$

Bllokimi i mjeteve bazohet në marrëveshje mbi kreditim deri në datën e përfundimit. Nëse mjetet e bllokuara janë valutë e pranuar e cila i përket shtetit të huaj, atëherë si masë mbrojtëse aplikohet: shuma e kredisë dhe interesit+përqindje e caktuar e totalit te përgjithshëm deri në datën e përfundimit, sipas marrëveshjes mbi kredinë respektivisht planit të amortizimit të kredisë.

- Kreditë hipotekare: kredi të cilat për kolateral kanë një hipotekë dhe shërbejnë për blerjen e hipotekës (në terminologjinë bankare e njohur si Mortgage loan).
- Kreditë bujqësore: blerja e pajisjeve, mjeteve të ndryshme dhe të gjitha të mirave që kanë të bëjnë me bujqësi, blegtori, pylltari etj.
- Kreditë për biznese të vogla dhe të mesme: Shërbime dhe mbështetje financiare që iu nevojitet atyre ndërmarrjeve për t'u zhvilluar dhe për të qenë të suksesshme në afarizmin e përgjithshëm të tyre.

Kohëzgjatje: afatshkurtër deri në 12 muaj, afatmesëm deri në 60 muaj, afatgjatë mbi 60 muaj.

- Kreditë për korporata: janë të një lloji të veçantë; Financimi i investimeve, Mbitërheqja, Kredi për qëllime të ndryshme, Linja e kredisë, Financimi i projekteve
- Auto kreditë: Blerja / importimi i mjeteve, veturave për nevoja personale
- Sigurimet e kredive: deri më sot në bazë të informatave që posedojmë bazuar nga hulumtimi i bërë ,nga të gjitha bankat që operojnë në Kosovë,është vetëm një bankë që ofron këtë produkt duke bërë sigurimin, për raste të caktuara të cilat janë të përshkruara në policën e sigurimeve .
- Lizing financiar për makina, pajisje dhe makineri, patundshmëri:Bazuar në kontratën për lizing, patundshmëria, makinat apo pajisjet e blera, gjatë tërë kohës do të jenë në pronësi të drejtpërdrejtë të bankës ndërsa klienti emërohet si shfrytëzues i autorizuar respektivisht kredi-marrësi. Kjo do të kalojë në pronësi të kredi-marrësit me rastin e përfundimit të kredisë.
- Kartelat: Visa credit, Visa classic, Visa electron, Maestro card, Master card

Kohëve të fundit po vjen në shprehje përherë e më shumë shfrytëzimi i kartelave. Derisa kartelat debit po bëhen atraktive duke kursyer kohën si dhe qasjen në fondet personale nëpërmjet ATM-ve dhe POS-ëve, kredit kartelat janë në afirmim e sipër sepse mundësohen pagesa duke u obliguar në atë mënyrë që të bëhet kthimi i fondeve të njëjta me këste, por pa interes.

Të lartpërmendurat janë vetëm disa nga produktet dhe shërbimet të cilat kanë të bëjnë me kreditë që aktualisht janë në dispozicion, nga bankat komerciale të licencuara për operim në Kosovë. Padyshim, objektivat e tyre janë të lidhura ngushtë me ngritjen e vlerave të aksioneve- maksimizimi i fitimeve,të cilat vijnë më së shumti në shprehje nëpërmjet produkteve të ndryshme kreditore,që si të tilla kanë trajtim të veçantë nga bankat komerciale. Në Kosovë sot operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale dhe përbëjnë 69.0 përqind të aseteve totale të sektorit financiar. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Qasja në shërbimet e këtyre bankave mundësohet përmes aktualisht 263 degëve dhe nëndegëve, 540 ATM-ve dhe 9,493 POS dhe 196,656 llogarive e-banking.¹⁸

Aktiviteti i tyre dominohet nga kreditë, afati i maturimit të të cilave mund të jetë deri në 15 vjet, varësisht nga lloji i kredisë. Nga totali i kredive, 65.2 përqind janë kredi për ndërmarrjet. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (51.8 përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë (përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë dhe ndërtimtarinë) ka 23.0 përqind të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori i bujqësisë aktualisht

¹⁸ www.bqk-kos.org

përbën 4.0 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare është 34.4 përqind të gjithsej kredive.

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përfaqësojnë 80.2 përqind të gjithsej detyrimeve. Depozitat e sektorit bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind, duke arritur vlerën prej 2.7 miliard euro. Depozitat e sektorit bankar në Kosovë përbëhen nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 74.4 përqind të depozitave të gjithëmbarshme, përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 20.1 përqind.

Bankat komerciale në Kosovë kanë strukturë të ndryshme aksionare. Tetë prej tyre janë banka me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor. Numri i të punësuarve në bankat komerciale është rreth 3,337.

Bazuar në gamën e produkteve dhe shërbimeve që sot ofrohen nga bankat komerciale nuk është vështirë të vërehen, se cilat produkte janë gjithnjë të sforcuara dhe me prioritet të veçantë, duke synuar maksimizimin e fitimit -në rend të parë.

Në mënyrë shumë të qartë vërehet se të gjitha shërbimet –produktet e mëposhtme, kanë lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kreditim.

- **Llogaritë:** rrjedhëse, të kursimit, afatizuese... etj
- **Depozitat:** të individëve privat, ndërmarrjeve të ndryshme publike, shtetërore, private.
- **Transferet e parave:** brendshme, vendore, ndërkombëtare.
- **Kanalet alternative:** e-banking, m-banking...
- **Kreditë personale:** që iu dedikohen individëve / ekonomive familjare
- **Mbitërheqjet/Flexi kreditë:** Mbitërheqjet zbatohen për ekonomitë familjare dhe bizneset.

Norma e interesit për mbitërheqjet bankare zbatohet kur llogaria rrjedhëse bëhet negative.

- **Kreditë konsumuese:** janë kreditë e dhëna për ekonomitë familjare me qëllim të përdorimit personal në konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Destinacioni i këtyre kredive është blerja e mallrave dhe shërbimeve të konsumit

- **Kreditë me para të gatshme:** Kreditë e mbuluara me para të gatshme lejohen duke bllokuar totalin e përgjithshëm nga mjetet e deponuara në llogari të veçantë dhe zbërthyer si vijon:

Totali = Shuma e kredisë + Interesi.

Bllokimi i mjeteve bazohet në marrëveshje mbi kreditim deri në datën e përfundimit. Nëse mjetet e bllokuara janë valutë e pranuar e cila i përket shtetit të huaj, atëherë si masë mbrojtëse aplikohet: shuma e kredisë dhe interesit+përqindje e caktuar e totalit të përgjithshëm deri në datën e përfundimit, sipas marrëveshjes mbi kredinë respektivisht planit të amortizimit të kredisë.

- **Kreditë hipotekare:** kredi të cilat për kolateral kanë një hipotekë dhe shërbejnë për blerjen e hipotekës (në terminologjinë bankare e njohur si **Mortgage loan**).
- **Kreditë bujqësore:** blerja e pajisjeve, mjeteve të ndryshme dhe të gjitha të mirave që kanë të bëjnë me bujqësi, blegtori, pylltari etj.

- **Kreditë për biznese të vogla dhe të mesme:** Shërbime dhe mbështetje financiare që iu nevojitet atyre ndërmarrjeve për t'u zhvilluar dhe për të qenë të suksesshme në afarizmin e përgjithshëm të tyre.

Kohëzgjatje: afatshkurtër deri në 12 muaj, afatmesëm deri në 60 muaj, afatgjatë mbi 60 muaj.

- **Kreditë për korporata:** janë të një lloji të veçantë; Financimi i investimeve, Mbitërheqja, Kredi për qëllime të ndryshme, Linja e kredisë, Financimi i projekteve
- **Auto kreditë:** Blerja / importimi i mjeteve, veturave për nevoja personale
- **Sigurimet e kredive:** deri më sot në bazë të informatave që posedojmë bazuar nga hulumtimi i bërë ,nga të gjitha bankat që operojnë në Kosovë,është vetëm një bankë që ofron këtë produkt duke bërë sigurimin, për raste të caktuara të cilat janë të përshkruara në policën e sigurimeve .
- **Lizing financiar** për makina, pajisje dhe makineri, patundshmëri:Bazuar në kontratën për lizing, patundshmëria, makinat apo pajisjet e blera, gjatë tërë kohës do të jenë në pronësi të drejtpërdrejtë të bankës ndërsa klienti emërohet si shfrytëzues i autorizuar respektivisht kredi-marrësi. Kjo do të kalojë në pronësi të kredi-marrësit me rastin e përfundimit të kredisë.
- **Kartelat:** Visa credit, Visa classic, Visa electron, Maestro card, Master card

Kohëve të fundit po vjen në shprehje përherë e më shumë shfrytëzimi i kartelave. Derisa kartelat debit po bëhen atraktive duke kursyer kohën si dhe qasjen në fondet personale nëpërmjet ATM-ve dhe POS-ëve, kredit kartelat janë në afirmim e sipër sepse mundësohen pagesa duke u obliguar në atë mënyrë që të bëhet kthimi i fondeve të njëjta me këste, por pa interes.

Të lartpërmendurat janë vetëm disa nga produktet dhe shërbimet të cilat kanë të bëjnë me kreditë që aktualisht janë në dispozicion, nga bankat komerciale të licencuara për operim në Kosovë. Padyshim, objektivat e tyre janë të lidhura ngushtë me ngritjen e vlerave të aksioneve- maksimizimi i fitimeve,të cilat vijnë më së shumti në shprehje nëpërmjet produkteve të ndryshme kreditore,që si të tilla kanë trajtim të veçantë nga bankat komerciale.¹⁹

4.3. Politikat e përgjithshme kreditore dhe shperndarja e portfolios kreditore

Sikur edhe në çdo vend tjetër edhe në Kosovë, siç u përmend edhe më lartë, Banka Qendrore luan një rol shumë të rëndësishëm si rregullatori për afarizmin e bankave në përgjithësi – duke përfshirë këtu edhe kreditë. “Një bankë qendrore, në përpjekje për të shmangur mbinxënjen e ekonomisë, nuk ua ndanë sytë të dhënave ekonomike, siç janë shifrat që kanë të bëjnë me porositë e fabrikave, tregun e shtëpive, **kreditimin e konsumatorëve**, shitjet me pakicë, prodhimin, ndërtimin, punësimin etj. “²⁰

¹⁹ Revista The Kosovo Banker/ Publikim I shoqatës së bankave të Kosovës – Qershor 2013

²⁰ Epping, Randy Charles.”A beginner’s guide to the world economy”, New York, Vintage books, a division of Random House, Inc, 2001, fq.59 (botuar ne shqip IDK Tirane 2007)

Bazuar në të lartshënuarën BQK-ja ka përcaktuar procedurat përkatëse të cilat e rregullojnë relacionin kredi-marrës dhe kredi-dhënës. Andaj secila bankë komerciale e cila operon në Kosovë është e obliguar që t'u nënshtrohet dhe respektoj këto procedura.

Kreditë huazohen nga bankat, me kërkesë të: Individëve privat apo ekonomive familjare si dhe Ndërmarrjeve / kompanive private dhe profesionistëve. Po ashtu vlen të përmendet se varësisht prej destinimit, kreditë kategorizohen në investuese dhe jo-investuese.

- **Kreditë investuese:** janë kreditë të cilat ndahen për blerjen e pajisjeve për prodhime të caktuara, agrikulturë, industri etj.
- **Kreditë jo-investuese:** janë kreditë me vlerë më të vogël dhe afat më të shkurtë që zakonisht shërbejnë për renovime respektivisht riparime të vogla.

Sigurisht që secila bankë ka për synim që me anë të kredive të shënojë ngritjen e fitimit sa më shumë që është e mundur. Meqë në Kosovë ka disa banka të cilat janë me seli qendrore në vend të huaj, vlen të përmendet se nuk do të thotë që të aplikojnë politika dhe procedura të njëjta (si në vendin e origjinës), pasi që në një mori rastesh të njëjtat dallojnë varësisht nga vendi-shteti në të cilat operojnë.

Është evidente se bankat që gjinden në Kosovë, vonë kanë filluar ta ashpërsojnë konkurrencën, kështu që me disa kriterë apo kushte, sfidohen ndërmjet vetes, por përherë në kuadër të rregullave të BQK-ës . Natyrisht kjo ndodhë si pasojë e konkurrencës. Sa për ilustrim po përmendim disa karakteristika që hyjnë në sferën e politikës kreditore që deri vonë, kanë qenë në një masë identike tek të gjitha bankat që operojnë në Kosovë. Ato janë: llojet e kredive, lartësia e shumës së ofruar, afatet, kushtet e përgjithshme dhe specifike, normat e interesit të kredive, lehtësitë për klientët e preferuar- (ekzistues dhe të rinjë), risku etj.

- **Llojet e kredive** - Kredi me destinacione dhe afate të caktuara, mbitërheqje, kartela kreditore.
- **Lartësia e shumës së ofruar** - deri në shkallën në të cilën klienti nuk rrezikohet të humbasë ritmin e kthimit të së njëjtës. Kujdes i duhur ndaj lartësisë së pakontrolluar të shumës që ndikon negativisht në portfolion kreditues. Por në secilin version të jenë konform depozitave të bankës.
- **Afatet** e kredive - afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë.
- **Kushtet e përgjithshme dhe specifike** - aftësia e kredimarrësit për gjenerim të hyrave (analiza/dokumentimi), shkalla konkurruese e kamatës, garantuesi / bashkë-huamarrësi.

- **Çmimorja** - të përcaktohet në atë mënyrë që të rezultojë me fitim, ku interesi / kamata domosdo të jetë më e lartë, se sa shpenzimet administrative dhe ato të përgjithshme të kredisë.
- **Lehtësitë/privilegjet** - për klientët e preferuar, (mbajtja e atyre ekzistues dhe tërheqja e klientëve të rinj).
- **Risku** – jo i fundit për nga rëndësia, padyshim ka rol të veçantë në politikën kreditore me caktimin e kritereve, norma të interesit dhe çmimit, duke u kujdesur me masa përkatëse ndaj afateve të kredisë dhe lartësisë së shumave të tyre, të mbuluara me kolateral adekuat. Bazuar në përvojë personale, kreditë afatgjata i nënshtrohen riskut më të madh për shkak të mundësisë reale që të përballet me vështirësitë e kthimit të kësteve të parapara me planin e amortizimit.

4.4. Krahasimi i normave të interesit në Depozita / Kredi

Normat e interesit në kredi dhe depozita u karakterizuan me trend rënës gjatë gjashtëmujorit të parë 2014. Norma e interesit në kredi u zvogëluar në 10.6 përqind në qershor 2014 (12.0 përqind në qershor 2013), ndërkaq ajo në depozita u zvogëluar në 0.6 përqind (3.5 përqind në qershor 2013). Rënia e theksuar e normave të interesit në depozita, ndër tjerash, u ndikua nga oferta e kënaqshme e depozitave, përderisa kreditë vazhduan të rriten me normë dukshëm më të ulët se depozitat.

Rënia e normës së interesit në depozita u shoqërua me rënie edhe të normës së interesit në kredi, por që nuk ishte aq e theksuar sa zvogëlimi i interesit në depozita. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi mund të jetë edhe refleksion i zvogëlimit të kërkesës për kredi sidomos nga ndërmarrjet.

Si rrjedhojë e zvogëlimit më të theksuar të normës së interesit në depozita në krahasim me interesin në kredi, dallimi i normës së interesit ndërmjet kredive dhe depozitave është rritur në 10.0 pp në qershor 2014 nga 8.5 pp sa ishte në qershor 2013. Kjo periudhë paraqet herën e parë që nga viti 2011 kur dallimi i normës së interesit ndërmjet kredive dhe depozitave ka shënuar rritje.

Në kuadër të normave të interesit për kredi, trendi rënës vërehet si te kreditë për ndërmarrje ashtu dhe te kreditë për ekonomitë familjare. Norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 10.5 përqind në qershor 2014, nga 12.1 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në kuadër të kredive për ndërmarrje, kreditë investuese u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit, ku norma mesatare për muajin qershor 2014 ishte 11.0 përqind (11.3 përqind në qershor 2013), përderisa kreditë tjera të biznesit kishin normë mesatare të interesit prej 11.6 përqind (12.1 përqind në qershor 2013). Sa i përket kredive për ndërmarrje, sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në qershor 2014 u regjistrua te kreditë tjera të biznesit me maturim ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (12.2 përqind), ndërsa më e ulëta u shënuar te kreditë investuese me maturim ‘mbi 1 deri 5 vite’ (9.9

përqind). Norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare u zvogëlua në 10.8 përqind në qershor 2014 nga 11.9 përqind sa ishte në qershor 2013.

Në kuadër të kredive të ekonomive familjare, norma e interesit për kreditë konsumuese ishte 10.9 përqind në qershor 2014 (12.2 përqind në qershor 2013), ndërsa norma mesatare e kredive hipotekare qëndroi në 9.5 përqind (11.5 përqind në qershor 2013). Tek kreditë hipotekare, me ulje më të theksuar të normave të interesit u karakterizuan kreditë me maturim ‘deri në 5 vite’ (9.8 përqind në qershor 2014 nga 13.6 përqind në qershor 2013) dhe ato me maturim ‘mbi 5 deri në 10 vite’ (9.5 përqind në qershor 2014 nga 11.2 përqind në qershor 2013), përderisa kreditë me maturim ‘mbi 10 vite’ kishin normën më të ulët të interesit prej 9.1 përqind në qershor 2014 (9.8 në qershor 2013).

Sa i përket sektorëve ekonomik, sektori i bujqësisë vijon të karakterizohet me normën më të lartë të interesit në kredi, ku norma mesatare në qershor 2014 qëndroi në 14.2 përqind. Megjithatë, krahasuar me qershor 2013, kur norma mesatare e interesit për kreditë e bujqësisë qëndroi në 17.6 përqind, vërehet se ka pasur rënie të konsiderueshme të interesit për këto kredi.

Pra, përkundër faktit se kreditë për sektorin e bujqësisë vazhdojnë të bartin normat më të larta të interesit, në periudhën e fundit, sektori i bujqësisë ka paraqitur sektorin me zvogëlimin më të theksuar të normës së interesit ë kredi. Norma mesatare e interesit në kredi për sektorin e industrisë në qershor 2014 ishte 11.3 përqind (12.0 përqind në qershor 2013), ndërsa për sektorin e shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë) ishte 10.2 përqind (11.6 përqind në qershor 2013). Norma më e lartë e interesit vazhdon të vërehet te kreditë bujqësore me afat maturimi ‘mbi 5 vite’ (16.5 përqind), ndërsa norma më e ulët ishte tek kreditë për shërbime me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 5 vite’ .

Normat mesatare të interesit në depozita gjithashtu shënuan rënie gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2014 dhe atë kryesisht gjatë periudhës prill-qershor 2014. Normat mesatare të interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluan në 0.3 përqind në qershor 2014 (3.6 përqind në qershor 2013), ndërsa për depozitat e ekonomive familjare u zvogëluan në 0.6 përqind (3.5 përqind në qershor 2013). Tek depozitat e ndërmarrjeve, sipas maturitetit, rënie shënuan të gjitha kategoritë.

Norma më e lartë e interesit (0.6 përqind), në qershor 2014, u has tek depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi ‘mbi 1 muaj deri në 3 muaj’ për shumat më pak se 250 mijë euro. Ndërsa, norma më e ulët e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ishte (0.01 përqind) për shumat mbi 250 mijë euro me maturim ‘deri në 1 muaj’. Tek depozitat e ekonomive familjare, sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në qershor 2014 (1.4 përqind) u regjistrua tek depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’, ndërsa më e ulëta (0.2 përqind) u has tek depozitat me afat maturimi ‘mbi 1 muaj deri në 3 muaj’. Vlen të theksohet se normat e interesit në depozitat e kursimeve si për ekonomitë familjare ashtu edhe për ndërmarrjet në qershor 2014 kanë shënuar rënie, përderisa vlera e depozitave të kursimit ka vazhduar të rritet.

Norma mesatare e interesit në depozitat e kursimit të klientëve në bankat komerciale, në qershor 2014, ishte 0.6 përqind (1.8 përqind qershor 2013), përderisa vlera depozitave të kursimit gjatë së njëjtës periudhë shënoi rritje vjetore prej 23.7 përqind.²¹

Tabela 1: Asetet Totale, Kreditë dhe Depozitat e bankave komerciale në Kosovë (2003-2013) sipas ABPK-së, AQBK-së dhe BQK-së.

Viti	Asetet Totale	Depozitat	Kreditë
2003	581.5 mil.€	518.8 mil.€	232.7 mil.€
2004	797.0 mil.€	692.3 mil.€	373.7 mil.€
2005	984.3 mil.€	836.6 mil.€	513.8 mil.€
2006	1,163 mil.€	926.4 mil.€	636.6 mil.€
2007	1,435 mil.€	1,141 mil.€	891.2 mil.€
2008	1,808 mil.€	1,444 mil.€	1,123 mil.€
2009	2,204 mil.€	1,744 mil.€	1,289 mil.€
2010	2,455 mil.€	1,937 mil.€	1,458 mil.€
2011	2,650 mil.€	2,102 mil.€	1,690 mil.€
2012	2,830 mil.€	2,279 mil.€	1,760 mil.€
2013	3,059 mil.€	2,449 mil.€	1,805 mil.€

Nga tabela më lartë kuptojmë mjaftë qartë, që sektori bankar në Kosovë dita ditës është duke e rritur profitabilitetin e tij, dhe është duke u bërë stabil karshi zhvillimeve ekonomike në rajon dhe botë. Këto shifra të lartë përmendura janë një segmentë i rëndësishëm, që sektori bankar në Kosovë është i qëndrueshëm, ka shkallë të lartë të likuiditetit, dhe është mjaftë profitabil.

Këtë shkallë ritëse nga viti në vitë, e segmenton një impakt mjaftë esencial që ka Kosova, se bankat komerciale në Kosovë, shumica prej tyre kanë traditë të mbijetesës në vendet e pazhvilluar dhe në zhvillim, ngase me këtë shkallë të papunësisë, rritjes ekonomike, deficitit buxhetor, e tregtar, do të ishte problematike mbijetesë bankare, mirëpo këtë mbijetesë, e ka ndihmuar edhe valuta zyrtare që ka Kosova, euroja (€), e cila është mjaftë stabile në tregjet botërore financiare dhe kjo domosdoshmërisht ndikon në sektorin bankar të Kosovës.²²

²¹ Raporti i stabilitetit financiar nr 6. Djetor 2014 / BQK

²²https://www.academia.edu/12256848/Roli_i_sektorit_bankar_n%C3%AB_ekonomi%C3%AB_e_Kosov%C3%ABs_2000-2013_

5. Performanca financiare e Bankës Ekonomike (2010 – 2015)

5.1. Analiza e bilancit të gjendjes

Bilanci i gjendjes është si një fotografi financiare momentale e datës kritike që tregon gjendjen financiare të entitetit në një moment të dhënë kohe. Bilanci i gjendjes i Bankes Ekonomike per vitet 2010 – 2015 eshte paraqitur ne tabelen ne vijim. Të dhënat janë të paraqitura ne ‘000.

PASURITË	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Paraja në dorë dhe në banka	25581,00	23310,00	16477,00	14535,00	15222,00	15397,00
Balancat me BQK-në	9554,00	26615,00	24657,00	38095,00	10915,00	17572,00
Kreditë e dhëna klientëve	87235,00	93821,00	94736,00	103834,00	110147,00	122077,00
Patundshmëritë dhe pajisjet	1414,00	1513,00	7580,00	6957,00	6388,00	6226,00
Pasuria e paprekshme	53,00	137,00	109,00	68,00	305,00	271,00
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e korporatës	82,00	168,00	204,00	228,00	136,00	74,00
Parapagimet për ndërtimin e zyreve	0,00	5434,00				
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim			10852,00	13934,00	28141,00	21610,00
Tatimit i shtyrë në pasuri				117,00		
Asetet tjera	1081,00	895,00	731,00	439,00	669,00	692,00
Gjithsej pasuritë	125000,00	151893,00	155346,00	178207,00	171923,00	183919,00
DETYRIMET						
Depozitat e klientëve	113005,00	139473,00	142879	164631,00	157165,00	163751,00
Detyrime ndaj bankave					90,00	1393,00
Borxh i varur					1050,00	1050,00

Të hyrat e shtyra	556,00	675,00	454	559,00		
Detyrime të tjera					450,00	535,00
Detyrimi aktual tatimor						312,00
Llogaritë e pagueshme	171,00	274,00	471	229,00		
Gjithsej detyrimet	113732,00	140422,00	143804,00	165419,00	158755,00	167041,00
KAPITALI AKSIONAR						
Kapitali aksionar	11778,00	11778,00	14778	14778,00	14778,00	14778,00
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	102,00	102,00	102	102,00	102,00	102,00
Fitimi (Humbja) i/e akumuluar	-612,00	-409,00	-3338,00	-2092,00	-1712,00	1998,00
Gjithsej kapitali aksionar	11268,00	11471,00	11542,00	12788,00	13168,00	16878,00
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar	125000,00	151893,00	155346,00	178207,00	171923,00	183919,00

Tab.4 Burimi: Banka Ekonomike – Bilanci i Gjendjes per periudhen 2010-2015²³

Nga analiza financiare shohim se pasurit në vitin 2010 krahasim me 2015 kanë pas një trend rritës prej 58,919 euro, por e cila ka pasur edhe rënje nga viti 2013 ne 2014 .

Për deri sa pasuria kishte rritje shohim që edhe detyrimet kanë pas rritje për 53,309 euro e cila rritje ka rrjedh nga viti ne vit me një trend stabil të rritjes se pauris dhe po ashtu edhe renie nga viti 2013 ne 2014.

Kapitali i aksionareve ka shënuar rritje në proporcion të drejtpërdrejt me pasurin por edhe si rezultat i zvogëlimit të detyrimeve dhe atë në shumë prej 5,610 euro, e cila rritje është pasuar nga viti në vit me një trend stabil të rritjes.

Raporti i rezultateve financiare gjatë viteve 2010/2015

PASURITË	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Paraja në dorë dhe në banka	-8,88	-29,31	-11,79	4,73	1,15
Balancat me BQK-në	178,57	-7,36	54,50	-71,35	60,99
Kreditë e dhëna klientëve	7,55	0,98	9,60	6,08	10,83
Patundshmëritë dhe pajisjet	7,00	400,99	-8,22	-8,18	-2,54
Pasuria e paprekshme	158,49	-20,44	-37,61	348,53	-11,15
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e	104,88	21,43	11,76	-40,35	-45,59

²³ <http://www.bekonomike.com/>

korporatës					
Parapagimet për ndërtimin e zyreve		-100,00			
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim			28,40	101,96	-23,21
Tatimit i shtyrë në pasuri				-100,00	
Asetet tjera	-17,21	-18,32	-39,95	52,39	3,44
Gjithsej pasuritë	21,51	2,27	14,72	-3,53	6,98
DETYRIMET					
Depozitat e klientëve	23,42	2,44	15,22	-4,53	4,19
Detyrime ndaj bankave					1447,78
Borxh i varur					0,00
Të hyrat e shtyra	21,40	-32,74	23,13	-100,00	
Detyrime të tjera					18,89
Detyrimi aktual tatimor					
Llogaritë e pagueshme	60,23	71,90	-51,38	-100,00	
Gjithsej detyrimet	23,47	2,41	15,03	-4,03	5,22
KAPITALI AKSIONAR					
Kapitali aksionar	0,00	25,47	0,00	0,00	0,00
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Fitimi (Humbja) i/e akumuluar	-33,17	716,14	-37,33	-18,16	-216,71
Gjithsej kapitali aksionar	1,80	0,62	10,80	2,97	28,17
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar	21,51	2,27	14,72	-3,53	6,98

Tab.5 Krahasimi i Bilancit të Gjendjes per periudhen 2010-2015²⁴




Fig.5 Analiza e aktivës

Nga grafikoni për aktiven shohim se pasuria ka shënuar një rritje të ndryshueshme nga viti në vit , me pjesëmarrje nga 2.27 % në 14.72% të rritjes solide në raportet e viteve 2011-2013.

²⁴ H. Ismajli (2003) – Analiza Financiare – Ligjeratate Autorizuara, fq. 23 Prishtinë

Mirëpo kishte edhe rënie gjate viteve 2013/2014 per 3.53% por e cila eshte korigjuar duke kaluar ne rritje stabile per 6.98%, në raportet e viteve 2014 - 2015 .




Fig.6 Analiza e pasives-detyrimeve

Në proporcion të drejtpërdrejtë me Aktivën shohim në grafikon se edhe Pasiva ka lëvizje te ngjajshme.

Pra, sikurse edhe ne Aktivë shohim se edhe Pasiva kishte rritjet por edhe rëniet e përafërta në të njëjtat periudha. Ndryshimet më të mëdha i vërejmë në dy periudha të ndryshme dhe atë nga 2010/2011 në 2011/2012 përkatësisht nga 23.47% në 2.41% dhe nga 2012/2013 në 2013/2014 përkatësisht nga 15.03% në -4.03%.

Edhe pse lëvizjet e tilla nuk preferohen edhe aq, në një aspekt ato tregojnë për tentime te menaxhmentit për të ndryshuar situatën, dhe se rezultatet e tyre shihet se nuk kan munguar, vetem se ka nevoje per nje stabilitet me te madh ne te ardhmen e Bankes Ekonomike.




Fig.7 Analiza e passives- Kapitalit aksionar

Nga grafikoni shohim se trendi i raportit të Kapitalit aksionar nga viti në vit është stabil, mirëpo dallimi qëndron kryesisht tek vitet 2012-2013, ku nga raporti i viteve 2011/2012 me pjesëmarrje prej 0.62% ka një rritje tek raporti i viteve 2012-2013 në 10.80%. Stabilitetin e ngritjes stabile e arrin përsëri në raportin e viteve 2014/2015 në 28.17%. Pra, ngjajshem sikurse edhe me Aktiven dhe pjesen e pare te Pasives, edhe pjesa e dyte e pasives kaloi me levizje jo te vogla nga periudha ne periudhen tjeter.




Fig.8 Struktura e pasivës

Nga struktura e pasivës shohim se kapitali aksionar ka një lëvizje kryesisht stabile, por nëse krahasohet me diferencën e 5 viteve ka arritur në një rritje solide prej vetem 0.17% kjo si rezultat i rënies së kapitalit nga viti 2010 në vitin 2011 për 1.46% dhe ngritjes stabile nga viti ne vit.

Krahas Kapitalit Aksionar gjithashtut edhe obligimet e bankës nuk kanë lëvizshmëri të ndryshueshme të madhe.

5.2. Analiza e bilancit të suksesit

Bilanci i suksesit pasqyron rezultatin financiar të afarizmit të ndërmarrjes/bankës, i cili përfitohet nga raportet sasiore në mes të dalave dhe të hyrave. Qëllimi i përlogaritjes së të dalave dhe të hyrave nuk është konstatim i suksesit në shumën absolute, por i atij rezultati që mund të krahasohet me rezultatin e ndërmarrjes/bankës së njëjtë në një periudhë tjetër (të mëhershme).

Bilanci i suksesit i Bankes Ekonomike per vitet 2010 – 2015 eshte paraqitur ne tabelen ne vijim.

Të dhënat janë të paraqitura ne ‘000.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhurat nga interesi	9076	11636	12402	12986	13552	13571
Shpenzimet e interesit	-3626	-4859	-5397	-5557	-4116	-2896
Të ardhurat neto nga interesi	5450	6777	7005	7429	9436	10675
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	1758	2251	2406	2048	1879	1950
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	-113	-141	-204	-276	-397	-454
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet	1645	2110	2202	1772	1482	1496
Të ardhurat e tjera operative	284	346	12	31	48	53
Humbja neto nga këmbimi valuator	79		50	28	-6	-68
Të ardhurat	7458	9233	9269	9260	10960	12156
Shpenzime të tjera operative	-5014	-6063	-6646	-6828	-6995	-7460
Provizionimi për humbjet nga kreditë	-3056	-2927	-5552	-1303	-2897	-659
Gjithsej shpenzimet operative	-8070	-8990	-12198	-8131	-9892	-8119
Fitimi para tatimit	-612	243	-2929	1129	1068	4037
Shpenzimet e tatimit në fitim		-40		117	-127	-327
Fitimi neto për vitin	-612	203	-2929	1246	941	3710

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse						
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-612	203	-2929	1246	941	3710

Tab.6 Burimi: Banka Ekonomike - Bilanci i suksesit per periudhen 2010-2015

Analiza e rezultateve financiare nga pasqyra e suksesit për vitin 2010/2015

	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Të ardhurat nga interesi	28,21	6,58	4,71	4,36	0,14
Shpenzimet e interesit	34,00	11,07	2,96	-25,93	-29,64
Të ardhurat neto nga interesi	24,35	3,36	6,05	27,02	13,13
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	28,04	6,89	-14,88	-8,25	3,78
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	24,78	44,68	35,29	43,84	14,36
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet	28,27	4,36	-19,53	-16,37	0,94
Të ardhurat e tjera operative	21,83	-96,53	158,33	54,84	10,42
Humbja neto nga këmbimi valuator	-100,00		-44,00	-121,43	1033,33
Të ardhurat	23,80	0,39	-0,10	18,36	10,91
Shpenzime të tjera operative	20,92	9,62	2,74	2,45	6,65
Provizionimi për humbjet nga kreditë	-4,22	89,68	-76,53	122,33	-77,25
Gjithsej shpenzimet operative	11,40	35,68	-33,34	21,66	-17,92
Fitimi para tatimit	-139,71	-1305,35	-138,55	-5,40	278,00
Shpenzimet e tatimit në fitim		-100,00		-208,55	157,48
Fitimi neto për vitin	-133,17	-1542,86	-142,54	-24,48	294,26

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse					
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-133,17	-1542,86	-142,54	-24,48	294,26

Tab.7 Krahasimi i Bilancit të Suksesit per periudhen 2010-2015




Fig.9 Të ardhurat neto nga interesi

Neto të ardhurat nga interesi kanë një lëvizje të madhe jo të qëndrueshme gjatë viteve nga -20.99% deri ne 20.97% përkatësisht rënie ne vitet 2011/2012 dhe ngritje ne vitet 2013/2014 , kjo për shkaqe të ndryshme të moskthimit të kredive dhe pagesës së gjobave ndaj BQK-s për mos-arkëtimin e mjeteve nga situata të krijuara nga kushtet e pavolitshme ekonomike .Raporti më stabil duket në vitet e fundit edhe pse me një rënie por i qëndrueshëm dhe pozitiv.




Fig.10 Të ardhurat neto nga tarifrat dhe komisionet

Të ardhurat neto nga tarifrat dhe komisionet kanë një trend të rënies negative shumë të theksuar nga viti 2010-2013 dhe me nje ngritje stabile nga viti 2013/2014 në 2014/2015. Dallimi më i madh qëndron tek raportet e

viteve 2011/2012 dhe 2012/2013 ku nga 4.36% ka rënie të theksuar në -19.53% kjo si rezultat i ndrrimit të menaxhmentit dhe përforcimit të kontrollit perkatesishte monitorimit të vazhdueshem.




Fig.11 Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera operative

Edhe të ardhurat operative janë në proporcion të drejtpërdrejt me të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet pasi që edhe këtu kemi një trend të rënies së vazhdueshme . Mirëpo këtu rënie me e theksuar dallohet tek raportet e viteve të fundit ku ka rënie si tek të ardhurat operative dhe shpenzimet operative.




Fig.12 Fitimi neto per vitin

Neto fitimi në fillim të periudhës të marrë për analize ishte jashtëzakonisht jo i mire por trendi i rritjes tregon që në vitet e fundit kishte një raport pozitiv çka rezulton me neto fitim financiar. Dallimet në mes të pesë viteve janë për më shumë të mëdha për të mos thënë të pa krahasueshme në mes viteve 2010/2011 dhe 2011/2012, përkatësisht 2010/2011 dhe 2014/2015.

5.3. Analiza e Cash-Flow

Pasqyra e rrjedhës së parasë tregon lëvizjen e parasë në biznes për periudhën e caktuar. Me pasqyrën e rrjedhës së parasë nënkuptohet hyrja dhe dalja e cash-it. Tek pasqyra e rrjedhjes së parasë dallohen: paraja nga aktiviteti i biznesit, paraja nga aktiviteti financiar dhe paraja nga aktiviteti investiv.

Paraja nga aktiviteti i biznesit ka të bëjë me të gjitha hyrjet-daljet që burojnë nga biznesi

Paraja nga aktiviteti financiar ka të bëjë me hyrjet-daljet që rezultojnë nga bankat (produktet kreditore) apo sponzorizimet / donacionet eventuale si dhe pagesat e kredive eventuale.

Paraja nga aktiviteti investiv ka të bëjë me hyrje-daljet e parasë të cilat janë rezultat i investimeve në mjete fikse si dhe nga shitjet e tyre.

Të dhënat janë të paraqitura në '000.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Aktivite operative						
Fitimi/ Humbja para tatimit	-612	243	-2929	1129	1068	4037
Ndryshime për:						
Amortizimin dhe zhvlerësimin	585	583	824	997	1009	845
Humbje neto nga zhvlerësimi për huatë e klientëve	3056	2927	5553	1303	2897	659
Humbje nga çregjistrimi i pronave dhe pajisjeve	21	4	-4	27	5	2
Të ardhurat nga interesi	-10790	-13690	-14802	-12986	-13552	-13571
Shpenzimet e interesit	3739	5000	5601	5557	4116	2896
Humbja para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	-4001	-4933	-5757	-3973	-4457	-5132
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative						
Rezerva statutore	4454	-17061	-945	-2068	-29	-2592
Kredi për klientët	-26628	-9709	-6467	-10376	-10020	-12512
Aktive të tjera	-125	-5248	5517	292	-163	-23

Detyrime ndaj klientëve	26803	26045	3406	21689	-7359	7308
Detyrime ndaj bankave			197	-242	65	1303
Borxh i varur	153	119	-221	105	1000	
Detyrime të tjera	-3	103			-174	85
Fitimi pas ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet op.	653	-10684	-4270	5427	-21137	-11563
Interes i paguar	-3095	-4577	-5310	-5494	-4148	-3618
Interes i arkëtuar	10733	13886	14550	12922	13438	13477
Tatim mbi të ardhurat i paguar	-40	-126	-36	-24	82	47
Paraja neto e përdorur në aktivitetet operative	8251	-1501	4934	12831	-11765	-1657
Aktivite investuese						
Blerja/Shitja e pronave, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara	-752	-636	-6863	-330	-684	-651
Kthimet (blerjet) neto të letrave me vlerë	-4	-134	-10807	-3073	-14073	6548
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) nga aktivitetet investuese	-756	-770	-17670	-3403	-14757	5897
Aktivitetet financiare						
Rritja e kapitalit aksionar			3000			
Dividenti i paguar gjatë vitit	-671					
Neto paraja nga aktivitetet financiare	-671	0	3000	0	0	0
Rritja/(ulja) neto e parasë dhe ekuival. të saj	6824	-2271	-9736	9428	-26522	4240
Paraja e gatshme dhe ekuival. e saj në fillim të vitit	18757	25581	42185	32449	41744	15222
Paraja e gatshme dhe ekuiv. e saj në fund të vitit	25581	23310	32449	41877	15222	19462

Tab.8 Burimi: Banka Ekonomike – Cash-Flow per periudhen 2010-2015

Analiza e rezultateve financiare nga pasqyra e Cash-Flow për vitin 2010/2015

	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015
Aktivite operative					
Fitimi/ Humbja para tatimit	-139,71	-1305,35	-138,55	-5,40	278,00
Ndryshime për:					
Amortizimin dhe zhvlerësimin	-0,34	41,34	21,00	1,20	-16,25
Humbje neto nga zhvlerësimi për huatë e klientëve	-4,22	89,72	-76,54	122,33	-77,25
Humbje nga çregjistrimi i pronave dhe pajisjeve	-80,95	-200,00	-775,00	-81,48	-60,00
Të ardhurat nga interesi	26,88	8,12	-12,27	4,36	0,14
Shpenzimet e interesit	33,73	12,02	-0,79	-25,93	-29,64
Humbja para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative	23,29	16,70	-30,99	12,18	15,14
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative					
Rezerva statutore	-483,05	-94,46	118,84	-98,60	8837,93
Kredi për klientët	-63,54	-33,39	60,45	-3,43	24,87
Aktive të tjera	4098,40	-205,13	-94,71	-155,82	-85,89
Detyrime ndaj klientëve	-2,83	-86,92	536,79	-133,93	-199,31
Detyrime ndaj bankave			-222,84	-126,86	1904,62
Borxh i varur	-22,22	-285,71	-147,51	852,38	-100,00
Detyrime të tjera	-3533,33	-100,00			-148,85
Fitimi pas ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet	-1736,14	-60,03	-227,10	-489,48	-45,29

op.					
Interes i paguar	47,88	16,01	3,47	-24,50	-12,78
Interes i arkëtuar	29,38	4,78	-11,19	3,99	0,29
Tatim mbi të ardhurat i paguar	215,00	-71,43	-33,33	-441,67	-42,68
Paraja neto e përdorur në aktivitetet operative	-118,19	-428,71	160,05	-191,69	-85,92
Aktivite investuese					
Blerja/Shitja e pronave, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara	-15,43	979,09	-95,19	107,27	-4,82
Kthimet (blerjet) neto të letrave me vlerë	3250,00	7964,93	-71,56	357,96	-146,53
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) nga aktivitetet investuese	1,85	2194,81	-80,74	333,65	-139,96
Aktivitetet financiare					
Rritja e kapitalit aksionar			-100,00		
Dividenti i paguar gjatë vitit	-100,00				
Neto paraja nga aktivitetet financiare	-100,00		-100,00		
Rritja/(ulja) neto e parasë dhe ekuival. të saj	-133,28	328,71	-196,84	-381,31	-115,99
Paraja e gatshme dhe ekuival. e saj në fillim të vitit	36,38	64,91	-23,08	28,64	-63,53
Paraja e gatshme dhe ekuiv. e saj në fund të vitit	-8,88	39,21	29,05	-63,65	27,85

Tab.9 Krahasimi i Cash-Flow per periudhen 2010-2015

Aktivitetet operative




Fig.13 Cash Flow – Aktivitetet Operative

Nga aktivitetet operative shohim se Banka Ekonomike kishte lëvizje të ndryshueshme pothuajse gjatë gjithë periudhave me ngritje dhe rënie disproporcionale, qka nënkupton se menaxhmenti duhet të marr hapa konkret për stabilizimin e aktiviteteve operative.

Fitimi perkatesisht humbja para tatimit kishte lëvizje të mëdha me rënie dhe ringritje perkatesisht rënie të madhe në periudhën 2010/2011-2011/2012 dhe ngritje edhe pse me gjendje ende negative në periudhën 2011/2012-2012/2013, por që kjo ngritje ka rezultuar gjatë gjithë periudhave tjera deri sa ka ardhur në shkallën pozitive të ngritjes, kjo nënkupton se rënie e mëhershme, menaxhmenti e ka marr me shumë seriozitet dhe politikat e restriksioneve në shpenzimet operative kanë ndikuar që të ketë vazhdimisht rritje.

Edhe humbja para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative kishte lëvizje të ndryshueshme në fillim me rënie të vazhdueshme dhe në periudhat e fundit me ngritje të vazhdueshme por që ngritja nuk e ka arrit nivelin fillestar të gjendjes së analizuar, pra edhe në fund të periudhës 2014/2015 kemi për 8.15 % më pak se në fillim të periudhës së analizuar 2010/2011.

Edhe në fig. 17 mund të shohim se paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit në periudhën 2010/2011 dhe 2013/2014 kishin rezultate negative, nderkaq rezultate pozitive me të mirat gjatë periudhës së analizuar ishin në ngritjet e periudhës 2011/2012 kjo si rezultat i shfrytëzimit maksimal të parase nga ana e menaxhmentit të bankes. Pra paraja është shfrytëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme për kredit bankare dhe nevojat e tjera operative.

Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative




Fig.14 Cash Flow – Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet Operative

Edhe te ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet operative kemi nje lëvizje proporcionale me Aktivitetet Operative ne periudhat e njëjta. Sikurse Rezervat, Kredite per klient po ashtu edhe Fitimi përkatësisht humbja operative ka shenuar rezultate pozitive nga viti ne vit, qka nënkupton se aktivitetet operative jane monitoruar me kujdes nga ana e menaxhmentit.




Fig.15 Cash Flow – Aktivitetet Investuese

Nga aktivitetet investuese shohim se ngritjen me te madhe perkatesisht investimet me te mdhaja jane bere ne periudhen 2011/2012. Pas gjithë ketyre investimeve ne kete periudhe kuptohet qe edhe lëvizjet ne vitet pasuese jane te arsyeshme.




Fig.16 Cash Flow – Aktivitetet Financiare

Si rezultat i rritjes se kapitalit aksionar ne vitin 2012 ne periudhen 2012/2013 te analizuar shohim se kemi rënie per 100%, gjithashtu si rezultat i shpërndarjes se dividendes ne vitin 2010 shohim se ne periudhen 2010/2011 kemi po te njëjtin rezultat negative, me qe nuk kemi pasur shpërndarje tjeter te dividendes ne periudhat e analizes tone.

Duke pasur parasysh që Banka Ekonomike është nje bank vendore e cila qëllimin primar e ka rritjen e zhvillimit ekonomik, punësimin dhe faktor tjer të ngjashëm, bordi menaxhues i bankës nuk ka shpërndar dividendën por fitimin e ka inkorporuar në aktivite operuese dhe investuese të bankës.




Fig.17 Cash Flow – Keshi në fund

6. Procesi i kreditimit të NVM-ve në Republikën e Kosovës

6.1. Kreditë sipas aktivitetit ekonomik

Në kuadër të aseteve të industrisë bankare, kreditë përbëjnë pjesën kryesore të tyre. Kreditë e lëshuara për operatorët ekonomik e pëbëjnë pjesën më të madhe të gjithësej kredive.




Fig. 18 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Figura 18 tregon se vlera e kredive të lëshuara për aktivitete ekonomike në fund të vitit 2014 ishte rritur për 25.4 milion euro në krahasim me vitin 2013, përderisa në krahasim me vitin 2010, kjo paraqet një rritje për 220 milion euro apo për 21.5%.²⁵

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK										
										Milion euro
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	135.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	154.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	163.3	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	171.3	1,217.4
2014	49.4	19.7	148.9	17.1	104.2	664.0	49.7	17.1	172.6	1,242.8

Tab.10 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Në kuadër të gjithësej kredive sipas aktivitetit ekonomik, pjesën më të madhe të tyre e përbënin kreditë e lëshuara për tregëti. Siç shihet në tabelën 10 kreditë e lëshuara për sektorin e tregëtisë ishin rritur vazhdimisht gjatë kësaj periudhe krahasuese, duke shtuar kështu pjesëmarrjen e saj në kuadër të gjithësej kredive. Pas kësaj rradhiten kreditë e lëshuara për shërbime tjera, qëllime prodhimi, ndërtimtari dhe të tjera.

²⁵ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik - <http://bqk-kos.org/?id=55>

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK										
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restorantet	Tregti tjetër	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	13.3%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	13.5%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	13.7%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	14.1%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.0%	1.4%	8.4%	53.4%	4.0%	1.4%	13.9%	100.0%

Tab.11 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Në tabelën 11 shihet se tregëtia në të gjitha vitet krahasuese përbën më shumë se gjysmën e kredive sipas aktivitetit ekonomik, pas kësaj rradhiten kreditë për shërbime tjera, kreditë për prodhim, ndërtimtari, bujqësi etj.



Fig. 19 dhe 20 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Kreditë e lëshuara sipas aktivitetit ekonomik nëse krahasohen ndër vite, nuk kanë ndryshuar shumë në përbërjen e tyre. Kjo mund të vërehet edhe përmes figurave 19 dhe 20 të paraqitura, me ç’rast shihet se kjo përbërje dominohej nga kreditë e këshuara për tregëti me 51% (2010), përkatësisht 53.4% (2014), duke vazhduar me prodhimtarinë me 12.5% (2010), përkatësisht 12% (2014), pastaj me ndërtimtarinë dhe sektorët tjerë ekonomik.

6.2. Kreditë e reja

Kreditë e reja në industrinë bankare dominoheshin nga kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare në raport me kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare. Në të gjitha periudhat krahasuese ndër vite mund të vërehet rritja e kredive të reja për të dy kategoritë.

KREDITË E REJA NË INDUSTRIJË BANKARE			
Milion euro			
Përshkrimi	Korporatat jo financiare	Ekonomitë familjare	Gjithsej
2010	491.3	240.5	731.8
2011	508.4	293.7	802.1
2012	468.4	275.9	744.3
2013	467.9	294.1	761.9
2014	615.4	378.5	993.9

Tab.12 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Siç shihet në tabelën 12, në raport me vitin 2010, gjithësej kreditë e reja në vitin 2014 ishin rritu për 35.8%. Viti 2014 ka qenë njëkohësisht edhe viti rekord i shënuar për vlerën e kredive të reja të lëshuara nga industria bankare brenda një viti.




Fig. 21 dhe 22 Burimi: BQK – Kreditë e Korporatave Tjera Depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Figura 21 dhe 22 e paraqitur tregon se shpërndarja e kredive në korporatat jo financiare dhe ato të ekonomive familjare nëpër vite ka qenë afërsisht e njëjtë, duke mos shënuar ndryshime të mëdha edhe pse mund të vërehet një rritje e lehtë në pjesëmarje të kredive për ekonomitë familjare me përjashtim të vitit të fundit (2014) kur pjesëmarja e tyre u zvogëlua sërish në kuadër të gjithësej kredive të reja.²⁶

6.3. Afatet e kredive

Në përgjithësi kreditë për nga afatet e maturimit ndahen në:

Afatshkurta (me kohëzgjatje 12 muaj); Afatmesme (me kohëzgjatje 12 deri në 60 muaj) dhe Afatgjata (me kohëzgjatje më shumë se 60 muaj).

Kreditë afatshkurta dhe afatmesme e kanë anën e vet atraktive, për arsye se janë më lehtë të kontrolluara, më pak të kushtueshme, ngërthejnë në vete risk shumë të vogël për dështim, kushtet janë më të volitshme se sa kreditë afatgjata etj. Në Kosovë janë duke dominuar edhe më tutje kreditë afatshkurta dhe ato afatmesme (e sidomos ato afatmesme). Në kohët e fundit është duke u rritë gjithnjë e më shumë numri i kërkesave për kredi

²⁶ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese - <http://bqk-kos.org/?id=55>

afatgjata. Kjo vërtet sjellë risk më të madh se sa kreditë afatshkurta dhe afatmesme, por në anën tjetër sjellë edhe fitimin shumë më të madh .

Deri në fund të vitit 2014 të gjitha bankat komerciale në Kosovë kanë aplikuar afatet 84 muajsh për kreditë personale-familjare. Me fillim të vitit 2015 konkurrenca ishte shumë më e theksuar dhe kjo pat ndikim të drejtpërdrejtë duke i rritë ofertat në vlera dhe afate. Gjithashtu deri në fund të vitit të kaluar maksimumi i aplikacioneve bazuar në oferta të kredive personale respektivisht familjare ka qenë EUR 20,000.00€. Por, sot është rritë oferta në vlerën e kredive deri në EUR 30,000.00€ dhe afatet e kthimit 120 muaj. Një gjë e tillë bie në sy me risk të jashtëzakonshëm duke pas parasysh se oferta është me vlerë dhe afat të gjatë, ndërsa sigurimi i kthimit të qëndrueshëm sfidues.

Aktualisht nuk po duket efekti “domino” që do të thotë se nuk janë duke u ndikuar edhe bankat tjera në rritje të afateve të maturimit dhe shumave të kredisë, por është sfiduese duke pas për bazë trendët e zhvillimeve dhe hyrjet e bankave te reja ne treg.

6.4. Analiza e aplikacioneve kreditore për NVM-t në Banken Ekonomike

Ne Banken Ekonomike analisti kreditor për kredi biznesi duhet që ti ndjek disa procedura te rëndësishme që janë për ta bërë vlerësimin e duhur për një aplikacion biznesi , e të cilat janë :

Shitja :

- ✓ **Seleksionimi i klientëve** : bëhet nga ana e analistit të kredisë duke i përzgjedh klientët me kredit histori të mirë me Banken Ekonomike dhe bankat e tjera në treg , klientët e ri që kanë biznes aktivitet të mirë .
- ✓ **Planifikimi i punës** : analisti kreditor në baza ditore identifikon klientët ekzistues dhe klientët e ri , nevojat e klientëve dhe planifikon vizita me orar kohor për ti vizituar klientët.
- ✓ **Takimi me klient** : gjatë procesit të aplikacionit dhe vizitës në biznes analisti kreditor takohet me klientin ku e bën mbledhjen e informatave të nevojshme që nevojiten për analizën kreditore dhe sigurohet që këto informata janë në përputhje me procedurat e bankës .

Informatat e nevojshme që kërkohen për ta kompletuar një aplikacion janë :

Emri i klientit , mbiemri , adresa dhe numri i telefonit; Emri i biznesit , adresa dhe numri i telefonit; Pronari i kompanisë; Detyrimet tatimore nëse klienti ka ,qarkullim mbi 30,000 euro (në bazë të rregullorës së Autoritetit Tatimore të Kosovës – ATK); Përshkrim i shkurt i aktivitetit te biznesit; Numri i të punësuarve; Menaxherët kryesor të biznesit; Vitet e operimit në treg; Arsyeja e kërkesës për financim, shuma e kërkuar ,

dhe struktura e tërësishme e projektit nëse është investim kapital; Parashikimi i sa muajve planifikohet që të ri-financohet kredia; Historia kreditore e kompanisë; Të tjera (informata relevante).

- **Verifikimi i klientëve :** me verifikimin e klientëve nënkuptojmë atë që analisti kreditor duhet ta bëjë verifikimin nëse klienti është në listë të zezë në bankë , raportin kreditor të klientit , referencat nga furnizuesit,verifikimin e adresës së biznesit dhe pronën biznesore , ti kontrollon historinë kreditore të klientit në bankat tjera nëse ai ka , numrin e telefonit dhe referencat nga popullata lokale .
- **Vizita ne teren :** Gjatë vizitës ne teren analisti kreditor e bën vizitën e biznesit për te cilën behet aplikacioni i kredisë , e bën fotografimin e pronës qe mirret peng , pajisjet e luajtshme dhe mallin qe gjendet ne te .

6.5. Përgatitja e analizës financiare , analizës biznesore dhe vlerësimin e riskut

Analisti kreditor gjatë përgatitës së analizës financiare është i obliguar që ta përgatis Coala Raportin , gjendjen e Cash Flow dhe verifikimin financiar .

- **Përgatitja e Coala Raportit :** me këtë raport bëhet analiza financiare e klientit për minimum tri vitet e kaluara nga viti actual, nese nuk është biznes më i ri .
- **Përgatitja e Cash Flow raportit :** përgatitja bëhet për periudhën min. 12 mujore pasi që është marr kredia. Përgatitja bëhet për të gjitha llojet e aplikacioneve .Analisti kreditor analizën financiare të përgatitur dhe pritjet financiare i sqaron në komentet financiare që i bën gjatë përgatitjes së aplikacionit për ta dërguar në komisionin për vlerësim të aplikacionit apo ndryshe në komisionin shqyrtues ku do të merr përgjigjen se aplikacioni përkrahet për aprovim apo refuzohet.²⁷
- **Verifikimi i të dhënave financiare :** analisti kreditor obligohet që ta bën verifikimin e të dhënave financiare. Verifikimi nënkupton që analisti duhet ta bën kontrollimin e gjendjes se llogaris të klientit nëse klienti ka transaksione , nëse ka fatura të lëshuara , pagesa të klientëve nëse klienti importon të mira , pagesat e bëra te furnizuesi , deklaratat ndaj administratës tatimore ,shpenzimet , shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet tjera operative etj.

Pas përfundimit të proceseve më lart analisti kreditor e bën përgatitjen finale për kompletimin e aplikacionit duke u siguruar në vlefshmërinë e dokumentacionit dhe se te gjitha dokumentet e pranuar janë fotokopjuar nga dokumentet origjinale dhe e bën futjen e të dhënave të mbledhura dhe të analizuara në aplikacionin online të procedimit të aplikacioneve në komisionin vlerësues (departamentin e Riskut) për të marr përgjigjen sa i përket aprovimit apo refuzimit të aplikacionit (kredisë).

²⁷ H. Ismaili (2003) – KontrollidheRevizioni – Ligjeratatë e Autorizuara, fq.39, Prishtinë

Pas përfundimit të vlerësimit, analisti kreditor obligohet që të informoj klientin për çdo lloj të vendimit që mund të jetë . Nëse aplikacioni aprovohet në bazë të kushteve dhe procedurave të bankës atëherë nga ana e departamentit ligjor bëhet përgatitja e marrëveshjeve të kredisë me kushtet e negociuara gjatë procesit të aplikimit dhe të dy palët (huadhënësi dhe huamarrësi) e bëjnë nënshkrimin e marrëveshjeve të kredisë për ta dërguar marrëveshjen në departamentin e disbursimeve.

Ky departament ka për detyrë lëshimin e mjeteve të kredisë në llogarinë e klientit në bazë të kushteve të specifikuar në marrëveshjen e kredisë dhe pasi që bëhet disbursimi analisti kreditor e bën gjenerimin e planit të amortizimit të kredisë ku janë të specifikuar data e fillimit të pagesës së parë dhe e përfundimit të kredisë , kësti i kredisë i cili përbëhet nga dy pjesë siç janë kapitali dhe interesi , dhe shpenzimet administrative (nëse ka).

Pas disbursimit analisti kreditor duhet të sigurohet që mjetet janë përdorur për në bazë të kërkesës që është bërë për kredinë dhe vizita në teren duhet të bëhet një muaj pas disbursimit të kredisë .

Pas procesit të monitorimit analisti kreditor duhet ta përgatit raportin e monitorimit për ta dërguar në departamentin përkatës për tu kontrolluar dhe arkivuar.

Raporti i monitorimit që analisti kreditor e bën përbehet nga informatat të detajuara për shfrytëzimin e fondeve të financuara nga banka , situata biznesore e klientit, situata aktuale financiare e tij , të priturat për të ardhmen ,ekspozimi total i klientit në kredi ,marrëdhëniet me banka tjera nëse ka dhe analisti duhet që të bëjë edhe njëherë rishikimin e kolateralit të len peng për kredinë . Ne rastet kur kredia disbursohet në mënyrë të pjesshme (tranch) atëherë për secilën pjesë të pagesës që bëhet në bazë të faturave të deklaruara nga klienti për ndonjë furnizim atëherë duhet të bëhet secilën herë monitorimi.

6.6. Dokumentet e nevojshme për kredi biznesi

Në vijim është , një formë e ashtuquajtur lista kontrolluese/verifikuese e dokumentacionit të kërkuar nga bankat, për një kredi biznesi,me çrast më së miri ilustrohet i tërë procesi deri sa të mbërrijë një lëndë kreditore në nivelin e shqyrtimit final.²⁸

Lista kontrollese/verifikuese

Dega/banka: _____, Emri i kompanisë: _____ Numri i aplikacionit: _____,

- Pasqyra e të ardhurave dhe bilanci i gjendjës
- Rrjedha e parasë,historiati kreditor,propozimi për planin e amortizimit
- Përmbushja e kriterëve minimale sipas udhëzuesit

²⁸ Burim i informacionit është nga përvoja ime bankare ne Banken Ekonomike

- Fotot nga biznesi
- Foto të kolateralit të pasurisë së patundshme(nëse është e nevojshme)
- Dosja informative e klientit(customer information file) dhe verifikimi I listës së zezë
- Vonesat e kredisë (nëse klienti ka histori kreditore më bankën XY)
- Verifikimi në RKK(regjistri kreditor i Kosovës),për huamarrës/garantues etj
- Regjistrimi I biznesit dhe konfirmimi
- Kopjet e letërnjoftimeve për bashkëhuamarrës,garantues,ose të tjerët
- Lista poseduese dhe kopja e planit nëse sigurohet me patundshmëri
- Kolaterali-lista e inventarit e nënshkruar dhe vulosur nga klienti/huamarrësi
- Kolaterali-pajisjet e makinerisë e nënshkruar dhe vulosur nga klienti/huamarrësi
- Dokumentet valide të automjetit të regjistruar
- Historiati I pagesës së kredisë së mëparshme/në bankat tjera-ekstrakti I bankës
- Certifikata e TVSH për shumat mbi EUR 80,000
- Kontratat për shit-blerje për Kredi hipotekare
- Konfirmimi i blerjes dhe sigurimi CASCO(për Auto kredi)

7. Pozicionimi i Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës

Pasuritë/Asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike, deri me datën 31 Dhjetor 2015 kanë qenë 184 milion Euro, ndërsa me 31 Dhjetor 2014 kanë qenë 171 milion Euro. Pasuritë/Asetet e Bankës janë rritë për rreth 12 milion euro.

Pjesëmarrja në Kredi

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total kreditë në treg, me datë 31 Dhjetor 2015 ka qenë 6.61 përqind nga totali i sektorit bankar.




Fig. 23 Pozita e Bankes Ekonomike ne potencialin kreditor ne tregun e vendit

Pjesëmarrja në Depozita

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në total depozitat në treg, me datë 31 Dhjetor 2015 ka qenë 6.20 përqind të total sektorit bankar.




Fig. 24 Pozita e Bankes Ekonomike ne depozita ne tregun e vendit

Siç mund të shihet, gjatë vitit 2015 Banka ka rritur pjesëmarrjen në treg, me ç'rast tregu është rritur për 7.3 përqind ndërsa rritja e Bankës Ekonomike është 9.2 përqind.

Ky është një tregues i mirë, që e bënë këtë trend dhe ndryshimet e bëra do të ia mundësojnë të rrisin pjesëmarrjen në treg përgjatë periudhave në vijim.

Gjatë vitit 2015 Banka ka përmirësuar gjithashtu indikatorin e efijencës (raportin e të hyrave me shpenzime / CIR), rrjedhimisht ky raport është përmirësuar nga 64.07 përqind në 59.86 përqind.

Me përmirësimin e proceseve të Bankës, dhe optimizim të kostove, Banka Ekonomike në vazhdimësi do të përmirësoj këtë indikator me rëndësi.

7.1. Ecuria e Kredive

Me angazhimin e intensifikuar të Bankës Ekonomike, portfolio e kredive ka shënuar rritje të qëndrueshme në vazhdimësi përgjatë gjithë periudhave të vitit, duke përfshirë sektorin privat dhe atë të biznesit. Gjatë vitit 2015, portfolio e kredive është rritur nga 120.7 milion kredi, në 131.9 milion në fund të vitit 2015.




Fig. 25 Krahasimi i kredive te Bankes Ekonomike ne depozita ne periudhen e analizuar 2010-2015

7.2. Ecuria e Depozitave

Portfolio e depozitave të bankës përbëhet nga një bazë e fuqishme dhe e qëndrueshme e klientëve, që vijnë nga klientët fizik dhe juridik. Gjatë vitit 2015 depozitat kanë shënuar rritje për 8 milion euro, respektivisht nga 154.9 milion euro sa ka qenë niveli i depozitave në Dhjetor 2014, ka arritur në 163.5 milion euro në fund të vitit 2015.



Fig. 26 Krahasimi i depozitave te Bankes Ekonomike ne depozita ne periudhen e analizuar 2010-2015

7.3. Mikro bizneset

Në vendin tonë shumica e bizneseve i takojnë grupit të bizneseve mikro ku nevojat për shërbime financiare janë të vazhdueshme. Duke marrë parasysh këtë fakt, Banka Ekonomike ka vazhduar të ofrojë shërbime kreditore dhe ka intensifikuar angazhimin në ofrimin e shërbimeve jo-kreditore në mënyrë që të jemi në përputhje dhe përmbushje të nevojave të këtyre klientëve dhe përkrahje në zgjerimin e këtij segmenti të biznesit. Ky angazhim shprehet edhe përmes numrit të klientëve i cili në vazhdimësi është rritur gjatë vitit 2015. Krahas zhvillimit të tregut, banka ka ndërmarrë gjithashtu hapa të brendshëm në përpilimin dhe përshtatjen e politikave të saja të brendshme me nevojat dhe avancimin e sistemit të bizneseve. Përveç pjesës procedurale banka ka ndërmarrë procesin e identifikimit të të gjitha proceseve ditore në degë.

Kjo analizë ka për qëllim të identifikoj të gjitha mundësitë drejtë përmirësimit të shërbimit ndaj klientëve të bankës. Përputhja e qëllimeve të dyanshme njëkohësisht shihet edhe në rritje të konsiderueshme të portfolios kreditore në këtë segment.

Portfolio në këtë segment është rritur për 26 përqind krahasuar me vitin paraprak. Në vazhden e rritjes së bashkëpunimit me këtë segment, përvec tjerash, banka ka qenë mjaft shumë e angazhuar në drejtim të rritjes së transparencës së bizneseve, rritjen e vetëdijesimit dhe kulturës financiare. Kjo mbetet objektive e vazhdueshme, të cilën banka do ta forcojë edhe në vitet në vazhdim përmes faktorëve të ndryshëm nxitës.

Banka Ekonomike është e vendosur fuqimisht të identifikohet si institucion financiar Model, e cila përbëhet tërësisht prej kapitalit vendor.

7.4. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Gjatë vitit 2015 banka ka reviduar politikat kreditore të këtij segmenti konform nevojave dhe kërkesave të klientëve. Produktet kreditore që i ofrohen këtij segmenti dhe organizimi i brendshëm në lidhje me procesin e kreditimit janë përshtatur në mënyrë që të plotësojnë dhe përkrahin biznesin e këtij segmenti.

Në mënyrë që Banka të jetë në përputhshmëri të plotë me ndryshimet në treg ,ka qenë mjaft të fokusuar edhe në zhvillimin e kanaleve alternative, të cilat kanë rezultuar me efikasitet në shërbimin ndaj klientëve.

Duke marrë parasysh volumin e ekspozimeve kreditore në këtë segment, mirëmbajtja dhe zhvillimi i marrëdhënieve afatgjata është i domosdoshëm.

Përveç tjerash janë modifikuar format e analizës financiare të cilat kanë derivuar rezultate shumë të mira në drejtim të rritjes së kualitetit të analizës financiare, njëkohësisht edhe ky proces është përcjellur me trajnime shumë specifike për analizë financiare dhe strategji të shitjes.

Duke ofruar shërbime kreditore të segmentit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, banka në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kontribuar në ngritjen e aktiviteteve ekonomike dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe pse ky segment dallon nga Mikro Bizneset për nga struktura organizative, gjegjësisht rezulton me një strukturë më komplekse, stafi i bankës ka arritur të ngritë nivelin e shërbimit tek bizneset e këtij segmenti. Ky segment është përcjellur me shërbimet e tjera bankare të cilat janë parë më shumë produktive në kursimin e kohës dhe njëkohësisht rritjen e efikasitetit të bizneseve.

Në këtë drejtim vlen të përmendet zgjerimi i rrjetit të pikave të shitjes (POS-ve), si dhe riorganizimi i tyre.

Tek kjo kategori e bizneseve i kushtohet rëndësi e vecantë formalizmit të qeverisjes efektive të korporatave të përcjellura me auditimin e pasqyrave financiare. Produktet kreditore të ndryshme dhe me modalitete të diversifikuara janë ofruar kryesisht për financimin e kapitalit punues, kreditë për asete fikse, renovim, ndërtim apo blerje të pasurive të paluajtshme.

7.5. Klientët individual

Kjo bank ka qenë mjaft shumë e fokusuar edhe tek klientët Individual, me rritje të numrit të klientëve në këtë segment për 12.5 përqind gjatë vitit 2015. Krahas rritjes së numrit të klientëve, në vitin 2015 është rritur edhe portfolio kreditore për 25 përqind, rritje kjo që dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të Bankës Ekonomike në mbështetjen e klientëve për realizimin e investimeve dhe arritjen e qëllimeve të tyre, duke ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve dhe standardit të jetesës.

Një konfirmim i besimit të klientëve në Bankën Ekonomike është niveli i depozitave dhe rritja e vazhdueshme e depozitave , 8.7 milion Euro ne krahasim me vitin paraprak.

Duke qenë e vetmja bankë me kapital 100% vendor, kjo e bënë të mburret dhe në të njëjtën kohë e vë para një përgjegjësie të lartë për aktivitetin dhe performancën e bankës në përgjithësi.

Kreditë sipas segmenteve '000 Euro	2013	%	2014	%	2015	%
Individë	29,298	26%	35,136	29%	43,984	33%
Biznese	83,220	74%	85,625	71%	87,972	67%
Kredite gjithsej	112,518	100%	120,761	100%	131,962	100%

Tab.13 Burimi: Banka Ekonomike– Kreditë sipas segmenteve

Gjatë vitit 2015 Banka Ekonomike ka pasur rritje në kredi prej 11.2 milion euro, ose 9.2 përqind. Kjo rritje kryesisht ka ndodhur si rezultat i aktiviteteve të intensifikuara duke përfshirë fushata të ndryshme për produktet kreditore të destinuara për klientët individual dhe klientët e biznesit. Këto fushata të marketingut, synim kryesor kishin qasjen ndaj klientëve me produktet e profilizuara të cilat janë komplementar me shërbimet elektronike. Këtu vlen të përmendet avancimi i shërbimeve elektronike dhe kartelave të kreditit të cilat plotësojnë nevojat dhe kërkesat e klientëve.

Gjatë vitit 2015, kjo bank ka qenë mjaft e fokusuar në diversifikimin e portfolios, me një fokus të veçantë tek mikro bizneset, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe klientët individual.

8. Trajtim empirik mbi NVM-të e marra si analizë rasti

8.1. Analiza e rasteve të studimit

Në vijim do ti paraqesim në të dhëna grafikore analizën e rezultateve financiare për dy kompanitë me veprimtari të ndryshme të cilët janë klient të bankës Ekonomike dhe të cilët kanë aplikuar për kredi. Rasti i parë është kur aprovohet kredia dhe rasti i dytë kur refuzohet nga ana e bankës.

8.1.1. Rasti i aprovimit të kredisë

Analiza e kredisë është bërë për kompanin e tregtimit të veturave Mercedes NTSH “Baaf”

Klienti meret me dy veprimtari biznesore që nga viti 2000, njera është servisimi dhe mirembajtja e autoveturave Mercedes dhe veprimtaria e dytë është shitja e autoveturave Mercedes. Ka sistem të kontabilitetit. Të gjitha dokumentet janë të vertetuara. Cilesia e dokumentacionit është e besueshme.

Ndermarja është themeluar në Dhjetor 1999 dhe regjistruar pranë ARBK më 04.08.2000. Biznesi ka përfaqesinë e Mercedes dhe përveq tregëtisë merret edhe me servisimin e automjeteve. Klienti deri më tani ka pas bashkëpunim shumë të mirë me PCB, që nga muaji shkurt 2015 klienti ka filluar të bashkëpunojë kryesisht me BEK dhe të gjitha ekspozimet kreditore i ka vetëm në BEK.

Veprimtari kryesorë e këtij biznesi është: shitja e automjeteve të reja të prodhuesit Mercedes Benz, furnizimi i pjeseve rezerve, servisimi, mirembajtja dhe riparimi i automjeteve ekskluzivisht të prodhuesit Mercedes Benz, kontrolli teknik dhe analiza, ndërmjetësim në tregëtinë e makinave si dhe dhenie me qera e automjeteve.

Në vitin 2002 janë transferuar në lagjen Dardania po në atë periudhë ku edhe janë licencuar dhe autorizuar si përfaqësi për brendin Mercedes Benz nga DAIMLER AG; në vitin 2003 kanë vazhduar me shitje dhe servisim në fshatin Malësi e Re-Prizren; me staf prej 18 punëtorësh në një ndërtesë prej 800m².

Prej Mars 2009 në objektin e ri, modern në Lutogllavë, objekti i cili është ndërtuar sipas projektit të Mercedes Benz të DAIMLER AG. Objekti është ndërtuar sipas standardeve Evropiane; në të cilën përfshihet servisi i pajisur me teknologji të ri dhe modern. Objekti përbëhet prej; showroom i cili ka një kapacitet 800m², zyret e menaxherëve, dhomat e trajnimit, pranimit, shërbimit pas shitjes – servisi me 900m², depo, recepcioni, bife, kuzhina, sipërfaqja e përgjithshme së cilës arrijn deri 3400m², si dhe parkingun me 5000m².




Fig. 27 Pjesemarrja e zerave kryesore ne bilancin e gjendjes tek aktiva e N.T.SH. “Baaf”

Nga kjo figure shohim se pjesa me e madhe e pasurise i takon asetete fikse dhe me e vogla tek Llogarite e arktueshme, qka nënkupton se kemi te bejme me nje biznes mjaft stabil sa i perket qendrueshmerise financiare.




Fig. 28 Pjesemarrja e zerave kryesore ne bilancin e gjendjes tek pasiva e N.T.SH. “Baaf”

Edhe nga ky grafik shohim se pasiva përbëhet kryesisht nga kapitali aksionar, me nje përqindje dominonte, duke u pasuar nga detyrimet afatshkurta. Edhe nga kjo shohim se kapitali aksionar i jep siguri dhe mjaft kolateral bankes per ti bere plasmanin e kredise.

8.1.2. Rasti i refuzimit të kredisë

Analiza e kredisë është bërë për kompanin NTP “Flori Commerce”

Klienti aplikon per here te pare per kredi ne BEK. Si biznes funksionon qe nga vitet e 90ta, ndersa si biznes I regjistruar funksionon nga data 01.09.2000. Biznesi ka nje histori mjaft te mire te zhvillimit te biznesit. Biznesi NTP Flori Commerce ka filluar te operoje qysh nga muaji Shtator I viti 2000 dhe qe nga ajo kohe ka operuar me mjaft sukses.

Sa i perket historise kreditore duhet theksuar qe klienti ka krijuar nje bashkepunim mjaft te mire me PCB dhe TEB me te cilat ka pas bashkepunim shum te mire dhe se i ka qendruar besnik secilit obligim qe ka pas ndaj tyre.

Si biznes eshte biznes individual I regjistruar prane ARBK me 01.09.2000. Veprimtaria e klientit eshte tregtia me shumice e drurit, materialit ndertimor dhe materialeve sanitare, tregeti te karburanteve, etj. Kete veprimtari klienti e ushtron qe nje periudhe te gjate kohore dhe qe nga ajo kohe ka operuar me mjaft sukses. Duke u bazuar ne kerkesat e vazhdueshme per produkte te tilla si dhe referuar procesit te ndertimeve dhe nevojen e patjetersueshme per produkte te tilla mund te themi qe kjo veprimtari eshte mjaft premtuese.

Biznesi menaxhohet nga vete pronari, djemte e tij dhe 6 punetore te tjere. Duke iu referuar natyres se punes duhet theksuar se vet klienti eshte ai I cili mirret ne teresi me procesin e punes duke perfshire ketu procesin e porosise se mallit, shperndarjen e mallit ne teritorin perkates, atakimin e klienteve potencial per shitje te ketyre produkteve, mbajtjen e raporteve ne nivel me klientet ekzistues etj.




Fig. 29 Pjesemarrja e zerave kryesore ne bilancin e gjendjes tek NTP "Flori Commerce"

Nga kjo figurë mund të konkludojm se biznesi nuk ka një pozitë të keqe financiare, por meqenëse niveli i obligimeve eshte me i madhe tek detyrimet afatgjata se sa ato afatshkurtera, si dhe shkalla e rrezikut eshte me e madhe pasi qe pronari ka vendimmarrjen kryesore dhe mirret pothuajse me te gjitha punet, pra ka nje mungese te sistemit menaxherial te kompanise, banka kete klient e ka refuzuar per plasim te kredise.

9. Përfundimi dhe rekomandimet

-Në kuadër të këtij punimi kemi shqyrtuar argumentet teorike dhe empirike të cilat mund të argumentojnë se menaxhimi i Bankës Ekonomike ka dy karaktere substanciale, karakterin përmbajtësor dhe karakterin e reputacionit.

-Banka ekonomike ka zbatuar lehtësime shtesë në politikat kreditore për financimin e NVM-ve ne raport me bankat konkuresuese ne tregun bankar te Kosoves prandaj ka pasur edhe luhatje të fitimit/humbjes financiare përgjatë periudhës së analizuar. Fokusi i Bankës Ekonomike nuk ka qenë vetëm profiti, por shërbimi, besimi, siguria dhe reputacioni, me çka edhe ka arritur që në vitin 2015 të ndryshoj gjendjen financiare te saj, pra duke eliminuar disa nga barrierat burokratike.

-Nepermjet politikave me te uleta te normave te interesit per klinetet e saje ne krahasim me konkurrent, nepermjet menaxhimit tolerues kur klinetet nuk kan pasur likuiditet te mjaftueshem per te kthyer kredin, nepermjet riafatzimit te kredive dhe nepermjet bashkemanxhimit te bizneseve ne funksion te ritjes se aftesis menaxheriale dhe ngritjes se performances ekonomike dhe financiare banka Ekonomike ka aritur te rit ne menyre permanente numrin e klineteles dhe te rit porfolion e kreditimit ne dem te profitabilitetit te saj ne afat te shkurt.

-Për ta menaxhuar në mënyrë efektive rrezikun, Banka Ekonomike përdor menaxhimin gjithëpërfshirës të rrezikut dhe teknikat e kontrollit. Funkzioni i menaxhimit të rrezikut siguron që rreziku kreditor, rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit, rreziku i investimeve, si dhe rreziku operacional në mënyrë efektive identifkohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen, në mënyrë që të sigurohet një raport i duhur ndërmjet rrezikut dhe kthimit.

-Duke e pas parasysh që tema ka të bëjë me financimin e NVM-e nga Banka Ekonomike, në bazë të hulumtimit të bërë mund të themi se Kosova është një nga vendet me normën e interesit (nominal dhe real) relativisht të lartë të kredive për NVM-të , të cilat përkthehen ne diferencë më të madhe në mes të normës së interesit për kredi dhe normave të interesit për depozita. Edhe pse ketu kemi të bëjmë vetëm me periudhën e analizuar 2010-2015.

-Mungesa e konkurrencës adekuate në tregun financiar, tregu i vogel ekonomik , rreziqet politike dhe te sigurise dhe jofunksionalitetit cilesor i institucioneve pubike si pasoje e politizimit dhe partizmit te tyre dhe ambienti biznesor i pavolitshme vlerësohen pergjithesisht si barrierat kryesore për normat e larta të interesit te kreditit krahasuar me rajonin e Ballkanit Perendimor.

-Evazioni i gjere fiskal dhe informaliteti i sektorit te biznesit pamundësojnë kompanit te prezenetojn pasqyra financiare objektive dhe per pasoje ato nuk përmbushin ne shumicen e rasteve kriteriumet ekonomike dhe financiare per marje te kredive dhe per ofrim te garnacioneve adekuate (kolateralit) per kredit e kërkuara.

-Banka Ekonomike duhet që të fokusohet në ngritjen e nivelit të shërbimeve edhe më të mira , zvogëlimin gradual te normave te interesave për kredit biznesore dhe të avancoj shërbimet elektronike më shumë në mënyrë që ta arrijë qëllimin e vet për të qenë nje nder bankat liderë në sektorin bankar në Kosovë .

-Funksionaliteti me i lart i institucioneve publike dhe ne veçanti gjykatave, ekzekutoreve (përmbauesve) , adminstrates publike dhe kadastrit ne kuptim te sigurimit me te leht te patundeshmerive me baze formale juridike do te ndihmonte shume ne racionalizimin e procesit te kredidhënies, uljes së normave të interesit për kredi dhe mbrojtjes se kredidhenesve dhe sanksionimit te debitorëve per mosbermbushje te detyrimeve financiare .

-Analiza e rezultateve na tregon mbi shfaqjen e problematikave, të cilat shoqërojnë tërë procesin e administrimit të kredidhënies nga ana e bankave, klientëve të tyre. Forcimi i rregullave dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e riskut kreditor në përgjithësi dhe atij përmes sigurimeve bankare në veçanti është një hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për një performancë më të mirë bankare.

-Unifikimi i elementeve mbi bazën e të cilave trajtohet menaxhimi i riskut kreditor duke u bazuar nga të dhënat e prezantuara nga ana e kredikërkuarit për të gjitha bankat përmes një rregulloreje apo dispozite ligjore është hapi i dytë për një menaxhim të suksesshëm të riskut të kredive dhe performancë më të mirë për secilën bank.

-Auditimi me intensiv i BQK-së ndaj bankave komerciale për respektimin e politikave strategjike për menaxhimin do të ndikonte në uljen e shkeljeve të këryre procedurave dhe politikave bankare, e të cilat i bëjnë shpesh për arritjen e targeteve momentale, por që ballafaqohen më vonë me mos kthime të kredive.

-Unifikimi i politikave të BQK-së sa i përket menaxhimit të riskut të kredive përmes sigurimeve bankare është një hap shumë i rëndësishëm për të gjitha bankat dhe ne ato suaza edhe per banken Ekonomike që të kenë menaxhim më efikas me riskun ne procesin e kredidhënies.

10. Literatura

1. Banka qëndrore e Kosovës , raportet e sistemit bankarë në Kosovë (2010-2016), Prishtinë.
2. Bullivant G. (2012), Credit Management, London
3. Dunn M. (1998), The Credit Policy Workbook: a step-by-step, easy, fill in the blanks guide (The Collecting Money Series Book 5), Washington.
4. Sawyer, M. (2014). Concept paper on effects of finance on industry under different financial systems, mimeo, Leeds.
5. Levine, R. (1997). Financial Development and Economic Growth: Views and Agenda. Journal of Economic Literature, Boston.
6. B. Mehmeti, (2008), metodat e hulumtimeve kërkimore-shkencore, Prishtinë.
7. G. Luboteni, (2011) “Bankat dhe afarizmi bankarë“, Prishtinë
8. G. Luboteni, (2008) “Menaxhmenti Bankarë” , Prishtinë
9. H. Ismaili (2003) – KontrollidheRevizioni – Ligjeratatë e Autorizuara, Prishtinë
10. H. Ismajli (2003) – AnalizaFinanciare – Ligjeratate Autorizuara, Prishtinë
11. J. Edward Ketz (2003) - Hidden Financial Risk Understanding Off-Balance Sheet Accounting, Washington.
12. McMillan J. (2014), The End of Banking: Money, Credit, and the Digital Revolution, Zurich.
13. Richard A. Brealey, Stewart C. Myers, Alan J. Marcus (2014) - Fundamentals of Corporate Finance, London.
14. Rufi Osmani “Analiza Pasqyrave Financiare (Leksione te autorizuara) (2017), Tetove
15. Rufi Osmani “Kontabiliteti Menaxherial” (2008) Tetove ,
16. Safet Merovci (2004) “Tregjet dhe instrumentet financiare”, Prishtinë
17. Simpson S.D. (2010), The Banking System, Sydney.
18. Sulo Haderi (2003) “Paraja , bankat dhe tregjet financiare “(Ekonomia monetare) , Tiranë.

Burime tjera

- a) http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf
- b) <http://www.bqk-kos.org/>
- c) <http://www.bekonomike.com/>
- d) <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,32>
- e) <https://raiffeisen-kosovo.com/sq/Financimi>
- f) <http://www.imf.org/external/index.htm>
- g) <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo>
- h) <http://www.monitor.al/stabiliteti-ne-sistemin-bankar-2/>
- i) <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/10/Banking-Sector-ALB.pdf>